



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 6336

NR. VENDIMI 5839

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqesore Lusjana Fezollari, sot më datë 13. 06. 2018,
mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjes civile me Nr. 6336` Regj.
Themeltar që i përket :

PADITESE E KUNDER-PADITUR: SHOQERIA “****” sh.p.k., me seli ne
***, me perfaqesues ligjor z. ***, e perfaqesuar ne gjykim me prokure te posaçme Nr.
*** dt. *** nga av. *** dhe av. ***.

E PADITUR KUNDER-PADITESE: SHOQERIA « *** » sh.p.k., shoqeri e
se drejtes tregtare kosovare, me seli ne ***, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim
perfaqesimi Nr. *** Prot. dt. *** nga av. *** dhe av. ***.

E PADITUR NE KERESE-PADI: SHOQERIA « *** » sh.p.k., me seli ne
***, me perfaqesuese ligjore znj. *** (ne mungese).

E PADITUR NE KERESE-PADI DHE KUNDER-PADI: DREJTORIA E
PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE, me adrese Bulevardi “Gjergj
Fishta”, Nr. 10, Kati V-Tirane, e perfaqesuar ne gjykim nga znj. *** ne baze te
autorizimit Nr. *** Prot. dt. *** leshuar nga Drejtori Pergjithshem z. ***.

OBJEKTI I KERKESE-PADISE: 1. Sigurimi i padise duke urdheruar :

Ndalimin e importit, nepermjet pikave doganore te RSH, te mallit miell gruri
“**** **”, me origjine nga Kosova dhe me prodhues shoqerine ***, ***.

Bllokimin fizik, konfiskimin dhe nxjerrien jashte qarkullimit te amballazheve,
paketimeve, te mbushura apo jo, te mallit Miell Gruri “**** **” te ndodhura ne
magazinat e importuesit shoqeria “****” sh.p.k.

Pezullimin e te gjitha veprimeve prane regjistrit te markave te DPPI lidhur me
marken “**** **” (fjale e figure) me numer *** e ***, me date regjistrimi ***, deri ne
perfundim te procesit.

Shfuqizimin e markes “**** **” (fjale dhe figure), me numer *** e ***, me date
regjistrimi *** me pronar shoqeria “****” sh.p.k., ***, per shkak se cenon te drejten e

pronesise industriale te markes se meparshme “*** **” (fjale dhe figure), qe eshte e mirenjohur ne tregun shqiptar.

Regjistrimin e vendimit te shfuqizimit ne regjistrin e markave te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industiale.

Publikimin e ketij vendimi ne mediat kombetare me shpenzimet e te paditurit.

Detyrimin e pales se paditur shoqerise “***” shpk, te ndaloje perdorimin e markes tregtare “*** **” (fjale dhe figure), nga te gjitha produktet ushqimore te perfshira ne klasen 30 te klasifikimit te Nices, duke perfshire ndalimin e importit ne territorin shqiptar, tregtimit, fushatave publicitare ne mediat kombetare, rrjetet sociale dhe materialeve te tjera promovuese si dhe reklamimin e produkteve ushqimore (miell gruri) nen marken “*** **” me numer *** e ***, me date regjistrimi ***, qe ne figure permban fjalen ***, dhe mosperseritjen e ketyre veprimeve ne te ardhmen.

Detyrimin e pales se paditur, shoqeri “***” sh.p.k. te paguaje shpenzimet gjvqesore te ketij procesi.

BAZA LIGJORE E KERKESE-PADISE: Nenet 142, 143, 156, 173, 184, 184/a, 184/c, te Ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Nenet 32, 103, 106, 154, 202 e vijues, 348 te K. Pr. Civile. Nenet 103, 105, 106, 608, 617, 625, 638, 639, 644 te K. Civil.

OBJEKTI I KUNDER-PADISE: 1. Shfuqizimi i markave tregtare “***, ***” (fjale dhe figure) me numra regjistrimi ***,***,***, pasi aplikimi per regjistrimin e markave eshte bere ne keqbesim nga shoqeria *** sh.p.k.

2. Regjistrimi i vendimit te shfuqizimit te markave “***, ***” (fjale dhe figure) me numra regjistrimi ***,***,*** ne regjistrin e markave tregtare te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale.

3. Pushimi i cenimit te drejtave te pronesise industriale te shoqerise “***” sh.p.k nepermjet ndalimit te Paditesit te Kunderpaditur-shoqerise “***” sh.p.k, qe te perdore marken tregtare *** dhe çdo shenje tjeter te ngjashme me te, gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare, pa autorizim te shoqerise “***” sh.p.k, duke perfshire edhe perdorimin e tyre per qellime marketing, reklamimi ose publiciteti.

4. Ndalimi i Paditesit te Kunderpaditur-shoqerise “***” sh.p.k, qe te perdore dhe te vendose marken tregtare *** dhe çdo shenje tjeter te ngjashme me te, ne mallrat ose ambalazhet e tij.

5. Ndalimi i Paditesit te Kunderpaditur- shoqerise “***” sh.p.k, qe te prodhoje, eksportoje, importoje, shperndaje, hedhe ne treg, ofroje per shitje, magazinoje, reklamoje dhe/ose te ambalazhoje produktet e tij me etiketen e markes *** dhe çdo shenje tjeter te ngjashme me te.

6. Bllokimi dhe shkaterrimi, me shpenzimet e Paditesit te Kunderpaditur-shoqerise “***” sh.p.k, te te gjithe produkteve te miellit “***”, te prodhuara dhe te shperndara ne tregun shqiptar (me shumice ose pakice) nga Paditesi/i Kunderpaditur, shoqeria “***” sh.p.k, si dhe te gjithe produkteve te tjera qe mund te gjenden tek çdo subjekt tregtar, ne magazine ose ne çdo vend tjeter ne Republikën e Shqiperise.

7. Ndalimi i veprimeve te konkurrences se pandershme nga Paditesit/te

Kunderpaditur, shoqerise “****” sh.p.k. dhe mosperseritja e veprimeve te tilla ne te ardhmen.

8. Detyrimi i Paditesit te Kunderpaditur-shoqerise “****” sh.p.k, te paguaje te gjithë shpenzimet gjyqesore duke perfshire edhe pagesat e kryera nga Paditesi K/Padites per sherbimet juridike, sic do te behen.

9. Publikimi i vendimit perfundimtar te gjykates ne median publike me shpenzimet e Paditesit /te Kunderpaditur, shoqerise “****” sh.p.k.

BAZA LIGJORE E KUNDER-PADISE: Nenet 156, 173, 184, 184/a, 184/b, te Ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Nenet 106, 160 dhe 348 te K. Pr. Civile. Nenet 638, 639 te K. Civil.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesueses se pales paditese te kunderpaditur, e cila kerkoi: Pranimin e kerkese padise sipas objektit te saj dhe rrezimin e kunder-padise, perfaqesuesin e pales se paditur kunder-paditese qe kerkoi: Rrezimin e kerkese-padise si te pa bazuar ne prova dhe ne ligj dhe pranimin e kunder-padise, pretendimet perfundimtare te perfaqesueses se pales se paditur ne kerkese-padi dhe kunder-padi DPPI, e cila e la ne cmim te gjykates zgjidhjen e kesaj ceshtjeje, pasi e shqyrtoi ceshtjen ne teresi ne mungese te te paditurit ne kerkese-padi, shoqerise “****” sh.p.k., në përfundim të shqyrtimit gjyqesor,

VEREN :

Se, paditesi shoqeria “****” sh.p.k., nepermjet perfaqesueseve te saj i është drejtuar kesaj gjykate, me kërkesë-padine me objektin e siperpermendur.

Nderkohe pala e paditur ne seancen pregatitore te dt. 05. 03. 2018 ne veshtrim te Nenit 158/b, 160 te K. Pr. Civile i paraqiti gjykates per shqyrtim se bashku me kerkese-padine, kunderpadine me pale, objekt dhe baze ligjore te percaktuar ne pjesen hyrese te vendimit. Nga ana e saj gjykata pasi e shqyrtoi kete kunderpadi ne aspektin procedural ne referim te Nenit 160 te K. Pr. Civile ne raport me kerkese-padine, vendosi me vendim te ndermjetem qe te pranoje kete kunder-padi per shqyrtim bashke me kerkese-padine pasi midis tyre kishte lidhje dhe mund te behej kompensim.

Gjithashtu referuar kerkimit te pikes 1 te objektit te kerkese-padise, gjykata ne veshtrim te Nenit 158/b, 202 e vijues te K. Pr. Civile vleresoi ne seancen pregatitore po te dt. 05. 03. 2018 dhe vendosi qe te mos pranonte kerkimin ne lidhje me sigurimin e objektit te kerkese-padise sipas permbajtjes se pikes se pare te saj, pasi e gjete ate te pa bazuar ne ligj procedural civil dhe material per pronesine industriale si dhe ne prova.

Pas kalimit te ketyre momenteve procedurale, fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kesaj ceshtjeje te paraqitur per gjykim dhe bazuar ne Nenet 36, 59 te K. Pr. Civile, konstatoi se ceshtja ben pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë të Nenin 41 të K. Pr. Civile : ”Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”. Meqënëse ndodhemi përpara mosmarrëveshjeve me karakter tregtar që rrjedhin nga marrëdhënia juridiko – tregtare e pronesine mbi markat, gjykata referuar dhe Neneve

334-335 te K. Pr. Civile çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencen tokesore ne bazë të Nenit 43 të K. Pr. Civile, “Kur i padituri eshte person juridik paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka qendren e tij...”. Nga ana tjetër neni 348 i K. Pr. Civile percakton se: «Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod”.

Sa me sipër, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane per shqyrtimin e kesaj ceshtjeje objekt konflikti.

Palet, bazuar ne Nenin 31, 32/a te K. Pr. Civile legjitimohen t’i drejtohen gjykates me keto kerkese-padi dhe kunder-padi ne baze te se cilave do te perfitojne te drejta personale – pasurore juridiko civile.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palet prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Paditese, shoqeria “****” sh.p.k. eshte nje subjekt tregtar, i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me date regjistrimi ***, me NUIS ***, me seli qendrore ne *** dhe me seli dytesore ne ***, ku nder te tjera per objekt te aktivitetit te saj ka dhe “tregtim lende te pare, materiale e mallrat e ndryshme industrial dhe per industrine e ndertimit me shumice e pakice, import dhe eksport i tyre...”.

Nga ana tjetër shoqeria “****” sh.p.k. eshte subjekt i se drejtes tregtare kosovare dhe ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj pane Agjencionit te Regjistrimit te Bizneseve ne Kosove me Nr. *** dhe si objekt te veprimtarise se saj nder te tjera ka dhe: “import dhe eksport, tregtim me shumice dhe pakice te miellit, grurit dhe produkteve te tjera ushqimore, etj”.

Pala paditese e kunderpaditur shoqeria *** shpk, qe prej krijimit te saj ne vitin 1999 ka hyre ne marredhenie kontraktore me palen e paditur dhe pa nderprerje ka importuar rregullisht nga pala e paditur kunderpaditese shoqeria *** shpk si prodhuese dhe furnizuese si dhe shoqeri te tjera ne Serbi, produktet miell gruri (tip 500 dhe tip 850), fare gruri, hime gruri, miser merkantil dhe grure, nen emrin ***.

*** shpk me daten *** ka aplikuar dhe ka regjistruar ne Drejtorine e Pergjithshme te Pronesise Industriale mbroitjen e markes tregtare “**** ****” e provuar kjo me: - Certifikata Nr. *** me date regjistrimi ***; - Certifikata Nr. *** me date regjistrimi ***, si dhe Certifikata Nr. *** me date regjistrimi ***.

Bazuar ne keto çertifikata dhe Ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë

Industriale”, i ndryshuar, keto produkte jane te mbrojtura ne emer te shoqerise “****” shpk deri ne vitin 2024.

*** sh.p.k. ka siguruar mbrojtje edhe ne dogane per marken e regjistruara “****” , fakt qe rezultoi i provuar me shkresen Nr. *** prot, date *** te Departamentit Operativ dhe Hetimor, prane DPD “Per miratimin e aplikimit per mbrojtjen e te drejtave te pronesise intelektuale”.

Marredheniet tregtare mes paleve ndergjyqese (*** sh.p.k. dhe *** sh.p.k) kane vijuar gjithnje ne rritje duke siguruar nje xhiro ne blerje nga ana e *** ne masen *** Euro per vitin 2016 dhe masen *** Euro per vitin 2017.

Prodhimi i Amballazhit per miellin e markes “**** ****”, behej ne cdo rast nga vete prodhuesi kompania *** sh.p.k., fakt i provuar nga deklarimet e perfaqesuesve te pales se paditur kunderpaditese, c’ka nenkupton se qe nga data 16.05.2014 e ne vazhdim thaset me logon “**** ****” jane prodhuar nga kompania *** shpk, fakt qe provon dijenine dhe miratimin nga kompania *** per marken e regjistruar nga shoqeria *** sh.p.k per territorin shqiptar. Ky amabllazh mbante ne cdo rast shenimin: Importues per Shqiperi *** sh.p.k. Tel: **, **. Web : www.***sh.p.k.com.al

Rezulton se ne fund te vitit 2017 furnizimi i mallit eshte bere ne paketimin me logon ***. Pala paditese *** sh.p.k, ka refuzuar te marre ne dorezim mallin per import me paketimin “**** ****” me shenimin Importues per Shqiperi *** sh.p.k. Tel: **, **. Web : www.***sh.p.k.com.al, duke e argumentuar kete refuzim me faktin se shoqeria *** sh.p.k. ka kontrate me shoqerine „****“ sh.p.k., parate jane parapaguar dhe malli qe kerkohej te importohej duhet te ishte “**** ****”. Ka gene pikerisht kjo ngjarje qe ka cuar ne prishjen e marredhenies tregtare mes paleve dhe ka vene ne levizje shoqerine *** sh.p.k per te kerkuar informacion prane DPPI. Keshtu, paditesi ka investuar DPPI me nje kerkese per hetim administrativ dhe ka marre dijeni me shkresen Nr. *** Prot. date *** te DPPI, per rezultatet e hetimit administrativ te kryer ne regjistrin elektronik te DPPI, lidhur me marken *** ose te ngjashme me te. Nga ky hetim administrativ ka rezultuar se; shoqeria “****” shpk, ka aplikuar 17 here qe nga viti 2014 e ne vijim dhe eshte refuzuar te 17 heret per te regjistruar marken tregtare miell gruri **, duke treguar sipas paditesit qellimin keqdashes me veprimet ne vazhdimesi te shoqerise “****” sh.p.k. per te regjistruar miellin e grupit tip *** nderkohe qe vazhdonte te furnizonte me kete mall paditin. Konkretisht referencat e aplikimeve te bera nga ana e shoqerise “****” shpk, per miellin e grurit *** dhe te refuzuara nga ana e DPPI jane : ***.

Nderkohe qe po nga e njejta shkrese (Nr. *** Prot date *** te DPPI), rezulton qe shoqeria “****” shpk ka arritur te regjistroje marken tregtare “**** ****” (me nje N-shenimi im) me daten *** per nje afat 10 vjecar, me Nr. regjistrimi *** dhe me afat 2016-2026.

Ardhur ne dijeni per kete fakt kjo pale ka paraqitur ne gjykate kete kerkese-padi me pale ndergjyqese, objekt dhe baze ligjore te cituar ne pjesen hyrese te vendimit, me pretendimet reth saj, sa me poshte citohet:

Sipas pales paditese te kunder-paditur, ne gjykim u shpreh se ajo ka ofruar gjate bashkepunimit tregtar me te paditurin, mirebesim, ndershmeri, respektim territorialiteti dhe besnikeri.

Shoqeria *** sh.p.k. gjate 19 viteve aktivitet tregtar me palen e paditur/kunderpaditese, Shoqeria “****” sh.p.k. ka qene ne kushtet e vullnetit te mire dhe ndershmerise ne biznes, fakt i cili vertetohet me veprimet e paleve ndergjyqese ne vazhdimesi, konkretisht:

- Aktivitet i panderprere per 19 vite rresht (besnikeri);

- Tregtim i mallit nen kete marke vetem ne tregun shqiptar, sipas marveshjes mes paleve;

- Menjehere pas regjistrimit te markes *** ***, paditesi ka vene ne dijeni shoqerine *** sh.p.k dhe nga ana e Shoqerise *** jane prodhuar pa hezitim dhe ne vazhdim per vite me radhe thaset e ambalazhit me Logon e Markes “**** **”;

- Deklarimin ne seance nga perfaqesuesi ligjor i pales se paditur se Kompania “****” sh.p.k e ka politike te saj faktin qe per te gjithe furnizuesit i prodhon vete ambalazhet;

- Por edhe perpara se te behej regjistrimi i markes *** *** nga deklarata doganore te paraqitura si prova nga “****” sh.p.k, provohet fakti se malli bihej se bashku me thaset per ambalazhim, ku “****” sh.p.k. ne cdo rast pa perjashtim ka prodhuar ambalazhin me logon e markes *** ***.

- Shenimi ne ambalazh ne cdo rast eshte, madje edhe sot qe nuk ka me kontrate ekskluziviteti mes paleve, si Importues per Shqiperi *** sh.p.k. Tel: ***, ***. Web : www.***sh.p.k.com.al

- Riperseritja e kontratave te ekskluzivitetit mes paleve, vit pas viti qe nga 2014 deri ne paraqitjen e padise.

- Pranimi i pagesave te bera me banke nga *** sh.p.k ne favor te “****” sh.p.k (fakt ky i provuar me transfertat bankare te bera nga *** sh.p.k).

- Vazhdimi i furnizimit te kompanise *** sh.p.k me produktet ***, fakt qe provohet me deklarata doganore te importit te paraqitura nga *** sh.p.k. dhe deklarata doganore te eksportit te paraqitura nga “****” sh.p.k.

- Intensifikimi i mardhenies se tregtise mes paleve, fakt qe provohet nga vlera e kontraktuar e mallrave per secilen kontrate. Kontrata e pare e ekskluzivitetit viti 2014 ka vleren *** Euro; - per vitin 2016 eshte afersisht *** Euro; - ndersa per vitin 2017 ***.

*Pala paditese “****” sh.p.k legjitimohet per ngritjen e padise ndaj pales se paditur “****” sh.p.k, per shkak te cenimit te te drejtave te pronarit te markes.*

*Nga hetimi gjyqesor rezultoi se Paditesi *** sh.p.k eshte cenuar ne te drejtat e tij, si pronar i markes tregtare dhe venia ne levizje e gjykates eshte veprim i duhur ligjor per te siguruar mbrojtjen e te drejtave qe rrjedhin nga neni 156 te Ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar.*

*Kjo pasi 3 vjet me vone se regjistrimi i kryer nga ana e paditesit te Kunderpaditur, shoqeria *** sh.p.k, regjistrohet ne kundershtrim me ligjin marka tregtare “**** **” e cila ka elemente ngjashmerie me marken “**** **”, konkretisht: a) Dizenjot *** dhe *** nuk*

kane asnje diference per konsumatorin. Pra, ka shtrirje gjatesore me nje tabele ne mes dhe tek tabela e mesit eshte vendosur dhe emri, ***, gje qe e ben te pamundur identifikimin e ndryshimit midis tyre nga konsumatori. b) Persa i perket aspektit fonetik te markes, pjesa kryesore dhe e dukshme identifikuese e markes eshte fjala ***, e cila ne gjuhen shqipe nuk perben diference ne shqiptim si me nje "N" ashtu edhe me dy "NN". c) Per me teper te dyja shoqerite e perdorin kete emer (***) , per te tregtuar te njejtin mall miell gruri. d) DPPI nuk duhet te kishte regjistruar marken tregtare "****" per shkak se ne nenin 143 pika 1 te Ligjit Nr. 9947, datë 07. 07. 2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, percaktohet se marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundërshtim me te drejtat e meparshme (te drejtat e meparshme *** ** qe ne vitin 2014). e) Nje konsumator i zakonshem e ka te pamundur te identifikojë ne treg kur blen miell gruri *** apo miell gruri **. Konfuzioni i konsumatorit eshte i pashmangshem. DPPI duhet te kishte qene shume me kujdesshme meqenese administron regjistrin elektronik dhe ngjashmeria shume e madhe, duhet te ishte bere shkak per refuzimin e ketij aplikimi, si te 17 aplikimet e bera me perpara nga shoqeria "****" shpk.

Marka "****", pronesi e pales paditese eshte tashme marke e mirenjohur ne tregun shqiptar, ku elementi verbal "****" gezon karakter te theksuar dallues. Nderkohe qe eshte pikerisht elementi "****" qe rezulton i inkorporuar dhe ne marken e kundërshtuar "****" te pales se paditur.

Pra pala paditese, *** sh.p.k legjitimohet per ngritjen e kesaj padie bazuar edhe ne nenin 143 te Ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar,

Pala e Paditur "****" sh.p.k, me veprimet e saj per te regjistruar nje produkt qe e dinte qe paditesi e kishte te mbrojtur dhe madje furnizohej prej saj me regjistrimin e ketyre produkteve ne daten 06. 09. 2016, eshte ne kushte e konkurences se pandershme te parashikuara ne nenin 638 te Kodit Civil.

Pala e Paditur "****" sh.p.k, nuk eshte kufizuar vetem me regjistrimin e nje marke te ngjashme per te njejtin produkt "miell gruri ***", me qellim konkurencen e pandershme, por ka vijuar me nje reklame televizive ne mediat kombetare kanali *** me kete tekst dhe reklama: "Preshendetje, ky eshte mielli *** i formuluar dhe i dezienjuar ne fabriken *** ne kosove. Ka vite qe punojme ne rritjen e cilesise dhe kualitetit , ne menyre qe *** te jete i perkryer ne cdo aspekt. Per hir te besimit qe kemi krijuar tek njeri tjetri, me duhet tu njoftoj qe ne treg po qarkullon nje imitim i dobet i miellit ***. *** nuk mban pergjegjesi per kete rast, ndaj lusim konsumatore tane besnik qe te kene shume kujdes. *** e vertete per tregun e shqiperise eshte kjo. Mielli *** dhe ****".

Pala e Paditur, shoqeria *** sh.p.k. jo vetem qe ka regjistruar nje marke te ngjashme, i njejtin grup mallrash, i njejtin produkt, per te njejtin treg, por ka ndermarre veprime konkrete duke eksportuar mallin mielli gruri nen marken e regjistruar dhe duke e tregtuar ate ne tregun shqiptar. Pas ngritjes se kerkese padise dhe pas rrezimit nga ana e gjykates te kerkeses per sigurim padie, i Padituri/Kunderpaditesi ka ndermarre nje fushate sensibilizimi, duke ftuar operatoret ekonomik shqiptar qe te importojne nga Kosova mallin MIELL GRURI ***, me çmim *** Euro/Ton, nga *** Euro/Ton qe furnizonte ****n sh.p.k, kur ishte distributor ekskluziv. (fakt ky qe u provua me disa deklarata doganore dhe kompanite te cilat jane furnizuar me mall nga Komapnia *** sh.p.k jane : *** ; *** , *** ,

*** . Rezultoi ne gjykim, se nga ane pales se paditur shoqeria *** sh.p.k mielli i paketuar nen marken “*** ***” eshte i njejte me miellin e paketuar nen marken “*** ***”. Pra i njejti mall paketohet nen dy marka te ndryshme vetem per efekt te konkureses se pandershme nga ana e pales se paditur Kunderpaditese, shoqeria “***” sh.p.k. Pra tregtimi i te njejtillit mall behet ne Kosove vedi furnizues me paketim me logo tjeter dhe ne Shqiperi me paketim me logo tjeter.

Pala e paditur “***” sh.p.k ka vepruar ne vazhdimesi ne keqbesim ndaj pales paditese “***” sh.p.k. per shkaqet se:

Marredhenia tregtare mes paleve ndergjyqese ka filluar ne vitin 1999 dhe ne vazhdim pa nderprerrje, megjithese menaxhimi i shoqerise *** shpk, ka ndryshuar 3 here qe nga koha kur ka filluar bashkepunimin, ndersa menaxhimi i shoqerise *** eshte i pandryshuar qe nga data e krijimit, shoqeria *** ka vazhduar pa nderprerje dhe me korrektese bashkepunimin tregtar.

Menjehere sapo *** shpk ka mbrojtur marken tregtare *** ne DPPI, ka njoftuar shoqerine *** per mbrojtjen e saj duke kerkuar qe paketimi/amballazhimi i mallit miell *** te behet nen marken *** ***, fakt i cili provohet lehtesisht nga amballazhi/thesi i depozituar si prove prane Gjykates.

Ne çdo rast prodhimi i amballazhit te miellit nen marken *** *** eshte bere nga prodhuesi *** shpk dhe ky fakt pasqyrohet ne thesin e amballazhit ku ne çdo rast eshte perdorur logoja e markes *** ***, prodhuar nga *** shpk.

*** ne vitin 2014 ka aplikuar 17 here per regjistrimin e marken *** ne DPPI, te cilat te 17 heret jane refuzuar.

Vetem pas ketyre refuzimeve i padituri ka tentuar te beje regjistrimin nderkombetar nepermjet nje shoqerie te huaj ***.

Nga verifikimet e bera ne WEB zyrtar te WIPO, rezulton qe marka tregtare *** ** tip *** me date regjistrimi *** jane regjistruar ne emer te *** me perfaqesues ne Shqiperi ***, i cili rezulton qe te jete emri tregtar i personit fizik *** me NIPT ***, qe eshte i njejti person qe ka aplikuar per mbrojtjen 17 here ne vitin 2014 prane DPPI. Mbrojtja eshte me fjale dhe figure per ngjyrat kafe, e kuqe dhe e verdhe (broun, red and yellow), pa prioritet, nderkohe qe eshte kerkuar qe te mbrohen edhe per territorin shqiptar dhe per kete arsye shfaqen edhe ne WEB zyrtar te DPPI.

Nderkohe qe nga viti 2014, kur *** ka aplikuar per mbrojtjen e markes ne DPPI apo ne vitin 2017 kur ka bere regjistrimin ne WIPO, i padituri ka vazhduar te furnizoj, shoqerine *** me miellin tip ***, me amballazhin e paketuar sipas markes se regjistruar nga *** shpk, duke ja prodhuar amballazhin me logon e markes *** *** dhe duke e bere vete amballazhin e produktin te prodhuar prej saj, miellit *** ne amballazhin me logon *** **.

Asnjehere qe nga viti 2014 dhe ne vijim, shoqeria *** nuk ja ka hequr statusin e distributorit ekskluziv shoqerise *** shpk per miellin tip ***, edhe pse ne heshtje dhe ne keqbesim, ka tentuar me shume se nje here, ta regjistroj ne tregun shqiptar dhe kur nuk ja ka arritur, ka tentuar, te beje regjistrim nderkombetar, duke perdorur te njetin perfaqesues ne RSh.

Te gjitha veprimet e kryera nga kunderpaditesi *** shpk dhe mosveprimet e tij deshmojne per keqbesim te kunderpaditesit *** shpk, ndaj *** shpk te cilat shprehen

konkretisht me:

- Rinovim i vazhdueshem i kontratave me shoqerine *** shpk, per miellin ***.
- Ruajtja e statusit per shoqerine *** shpk, te distributorit ekskluziv ne territorin shqiptar per miellin ***.
- Furnizimi pa nderprerje dhe ne rritje me miell *** te kompanise *** shpk.
- Porositja dhe prodhimi i ambllazhit me logon *** ***.
- Paketimi i mallit miell *** ne thase me logon *** ***.
- Arketimi i pageses nepermjet bankes per mallin miell *** , per shitjet qe jane bere nga *** drejt *** shpk.
- Mosnjoftimi nga *** te kompanise *** shpk, se ka pretendime ne lidhje me markat ***.

-Regjistrimi nga *** i markes *** , ne nje kohe qe nuk e prodhon kete produkt, e regjistrimi ne territorin shqiptar me qellim shkaktimin e konfuzionit tek klienti.

-Furnizimi i kompanive *** shpk, *** , *** dhe *** me produkte ***.

-Ndermarrja e nje fushate publicitare, ku fotoja eshte mielli *** nderkohe qe te njejten video titulli eshte *** dhe teksti qe shoqeron videon, shprehet se “per hir te besimit qe kemi krijuar me njeri tjetrin, me duhet tju njoftoj se ne treg po qarkullon nje imitim i dobet ***. *** nuk mban pergjegjesi per kete produkt te imituar ndaj lusim konsumatoret te kene shume kujdes”. Nderkohe qe mielli tjetër *** qe qarkullon ne treg, eshte po prodhim i kompanise *** , e furnizuar prej asaj vete me kontrata te rregullta.

-MIELL GRURI *** , me te cilin po furnizohet tregu shqiptar nga pala e paditur shoqeria “****” sh.p.k. aktualisht eshte nen çmim (*** Euro/Ton), nga ai (*** Euro/Ton) qe furnizonte ***n sh.p.k, kur ishte distributor ekskluziv. Ky fakt provohet me vleren e importit ne deklarata e paraqitura.

-Thesi i ambllazhimit per marken tregtare “*****”, me kuadratin e verdhe ne mes ka shenimin qe importues per Shqiperine eshte shoqeria “****” shpk. Ky fakt provon se eshte pikerisht shoqeria “****” shpk e cila eshte ne keqbesim, pasi fale faktit te mos pranimit te mases se sigurimit te padise, kjo shoqeri (***), importon ne tregun shqiptar produktin te markes “**** ***” nderkohe qe per territorin shqiptar ka mbrojtur “**** ***”. Per me teper shoqeria *** shpk, e ka te kuqe logon e markes dhe nderkohe ka hedhur ne tregun shqiptar logon me ngjyrat e mbrojtura nga shoqeria *** shpk. Edhe pse nuk ka asnje kontrate furnizimi me shoqerine *** shpk per vitin 2018, vazhdon te vendose shenimin ne ambllazh importues per Shqiperine *** shpk, tel *** , *** WEB: www.***shpk.com.al.

-Kompania “****” shpk, nuk njihet fare ne tregun shqiptar dhe tregu i miellit *** ne Republiken e Shqiperise eshte totalisht produkt i aktivitetit tregtar te shoqerise *** sh.p.k. Sipas padiesit eshte pikerisht ai si subjekt qe ka ndertuar tregun, e ka zgjeruar kete treg dhe i ka dhene kete profil qe ka sot ne vendin tone dhe veprimet e pales se paditur kunderpaditese synojne qe ne keqbesim te marrin segmentin e tregut qe paditesi ka krijuar per miellin ***.

Lidhur me kunder-padine sipas pales paditese, pala e paditur “****” sh.p.k nuk legjitimohet per ngritjen e kunderpadise se paraqitur ndaj saj.

Kjo pasi kunderpadia e paraqitur nga pala e paditur Shoqeria “****” sh.p.k, eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe si e tille duhet rrezuar per shkak se nga hetimi gjyqesor rezultoi se

:

Mbrojtja e markes “*** ***” qe pala e paditur ka bere ne territorin e Kosoves eshte pa prioritet, fakt ky qe provon se kjo marke gezon mbrojtje vetem per territorin e Kosoves dhe vete Kunderpaditesi nuk e kishte imagjinuar se do te kishte kete shtrirje ne territorin shqiptar.

Pala e Paditur/Kunderpaditese Shoqeria “***” sh.p.k, ka gene ne dijeni te plote te faktit se *** sh.p.k ka mbrojtur marken tregtare “*** ***” per territorin shqiptar, per shkak se se pari, ka prodhuar qe ne momentin e regjistrimit paketimin (thesin) me logon *** ***, se dyti, me daten 14. 10. 2014, eshte informuar me shkrim nga DPPI se i refuzohet regjistrimi i markes “*** ***”.

Pala e Paditur /Kunderpaditese Shoqeria “***” sh.p.k, qe nga 14. 10. 2014 e ne vazhdim nuk ka ndermarre asnje veprim ligjor (kerkese per shfuqizim) dhe tregtar (nderprerja e bashkepunimit ose heqja e statusit te ekskluzivitetit).

Kerkesa per shfuqizim te markes “*** ***” e paraqitur nga pala e paditur Kunderpaditese, shoqeria “***” sh.p.k eshte parashkruar, per faktin se ka kaluar te afatit 3 vjecar i parashikuar ne piken 4 te nenit 184/b te Ligjit Nr. 9947. Per kete pretendim referuar kronologjise se fakteve rezulton se markat tregtare “*** ***” jane regjistruar me Nr. *** date 15.05.2014, *** date 16.05.2014 dhe *** date 16.05.2014. Nga data 02.02.2018 (data kur eshte paraqitur kerkesa per shfuqizim ne DPPI) ka kaluar afati 3 vjecar i parashikuar ne nenin 184/b pika 4 te ligjit Nr. 9947 (konkretisht jemi pas 3 vjet e 3 muaj).

Bazuar ne nenin 184/b pika 4 te ligjit 9947 kjo kunderpadi duhet rrezohet per shkak se eshte paraqitur jashte afatit 3 vjecar per shkak se jo vetem qe ka kaluar afati i parashikuar ne ligj por qendrimi i mbajtur nga shoqeria *** duke mos vepruar per te mbrojtur te drejten e pretenduar nga ana e tyre, ben qe ky kerkim te jete parashkruar (referuar markes ***). Siç shprehen Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte ne vendimin Nr. 5 date 31. 05. 2011, “elementi thelbesor i parashkrimit nuk eshte kalimi i kohes ne vetvete por eshte mosveprimi/pasiviteti i titullarit te se drejtes (e drejta e pretenduar nga ***) per te mbrojtur brenda kohes se caktuar te drejten e tij (te pretenduar) te cenuar ose te mohuar”.

Pretendimi i pales se paditur ne Kunderpadi se Paditesi shoqeria *** sh.p.k ka vepruar ne keqbesim, rezultoi i pavertete nga shqyrtimi gjyqesor per shkak se : Produkti miell *** ne RSH eshte tregtuar vetem nga shoqeria *** shpk qe prej krijimit e ne vazhdim. Kjo provohet me deklaratat doganore te importit si dhe me transfertat bankare. Shoqeria *** shpk nuk njihet fare ne tregun shqiptar, nuk ka dege te shoqerise te saj ne RSH dhe tregu shqiptar e njeh kete produkt nen emrin e markes *** ***. Segmenti i tregut shqiptar qe konsumon kete produkt eshte krijuar, ndertuar, zgjeruar, rritur nga *** shpk. Vetem tani qe produkti i miellit *** *** eshte konsoliduar ne tregun shqiptar (nga *** shpk), keto te drejta pretendohen nga kompania ***.

Keqbesimi i pretenduar nga kunderpaditesi *** shpk, nuk qendron per arsytet se:

Se pari: ka gene vet DPPI ajo qe refuzuar regjistrimin e markes *** ne emer te ***

Se dyti: ka gene vet *** qe ka vazhduar ti njohe te drejten e distributorit ekskluziv *** shpk; ka vazhduar te nenshkruaje kontrata gjithmone ne rritje me *** shpk, te arketoje transfertat bankare me parapagim nga *** Shpk per produktin ***, te prodhoje amballazhin

me logon *** ***, te amballazhoje vete mallin miell gruri ne amballazh *** ***, duke mos harruar qe ne çdo amballazh te vere shenimin qe ky amballazh eshte prodhuar nga *** shpk.

Fakti qe *** ka mbrojtur marken tregtare vetem dhe ekskluzivisht per territorin shqiptar pa synuar kurre shtrirjen e kesaj mbrojtje jashte territorit shqiptar, provon edhe njehere qe veprimet e shoqerise *** shpk jane ne mirebesim total dhe duke respektuar etiken me furnizuesin dhe llojin e mardhenieve te ndertuara mes paleve. Mielli *** eshte tregtuar dhe shperndare ne territorin shqiptar qe nga krijimi deri ne dhjetor 2017, ne menyre te pandreprete vetem nga shoqeria *** shpk, duke shenuar nga viti ne vit rritje shume cilesore persa i perket pozites ne treg te ketij produkti.

Me tej paditesi pretendoi se ne lidhje me kunder-padine rezulton qe objekti i saj, eshte i paqarte dhe me kerkime te pamundura dhe kontradiktore per arsyet se : Nga 9 pikat e objektit te kunderpadise, 3 prej tyre lidhen me marken tregtare *** ***, 3 te tjera lidhen me marken tregtare *** (nderkohe qe objekti i padise eshte *** ***), 1 pike ka te beje ka te beje me konkurrencen e pandershme dhe 2 te tjera kane te bejne me shpenzimet.

Kerkimet ne kunderpadi jane te pastrukturuara, 4 prej tyre (3, 4, 5 dhe 7) jane imagjinare, veprime qe nuk kane ndodhur kurre dhe per rrjedhoje kjo kunderpadi nuk duhet te ishte pranuar per gjykim. Me konkretisht kunderpaditesi duhet te saktesonte nese kerkon te drejtat e pronesise mbi marken *** apo ***, per me teper kunderpaditesi eshte i paqarte nese i pretendon te dyja apo jo.

Marka ***, nuk listohet ne produktet e prodhuara nga kompania ne rrethanat e faktit te kunderpadise. Kjo eshte nje prove e qarte qe produkti miell ***, tregtohet ne territorin e Republikes se Shqiperise me emrin *** dhe kjo behet me qellim dhe ne keqbesim te hapur nga ana e kunderpaditesit, fakt qe provohet me argumentat e sjelle nga vete kunderpaditesi qe nuk prodhon miell *** dhe e dyta marka tregtare *** eshte regjistruar nga kunderpaditesi vetem ne RSH dhe ne asnje vend tjeter. Qellimi i hapur i kunderpaditesit eshte qe te sjelle konfuzion ne treg.

Persa i perket pikes 3 te objektit te kunderpadise ku kerkohet “pushimi i cenimit te te drejtave te pronesise industriale te shoqerise *** shpk, nepermjet ndalimit te shoqerise *** shpk qe te perdore marken tregtare ***”, kunderpaditesi e ka te pambeshtetur pasi nuk ka asnje prove te paraqitur deri tani dhe ne fakt nuk ka ndodhur kurre qe shoqeria *** shpk te kete perdorur qofte edhe njehere te vetme marken tregtare *** (as marketing, as reklamim as publicitet), ç’ka nenkupton qe ky kerkim ne objektin e kunderpadise eshte i pambeshtetur dhe praktikisht nuk ka lidhje materiale me padine dhe pranimi i kunderpadise me kete pike ne objekt eshte ne kundersizim te hapur me kerkesat e nenit 160 te K.Pr.Civile.

Ne piken 4 te objektit te kunderpadise, kunderpaditesi kerkon “Ndalimi i paditesit te kunderpaditur *** shpk, qe te perdore dhe vendose marken tregtare ***...ne mallrat ose amballazhet e tij“. Edhe ky kerkim eshte absurd dhe i pambeshtetur per shkak se *** shpk, ka tregtuar vetem marken tregtare *** dhe ne asnje rast ***. Pra kjo pike e objektit te kunderpadise eshte kerkim i pabaze, i cili edhe ne rast se do te pranohej nga Gjykata, do te ishte e pamundur venia ne ekzekutim ne praktike pasi nuk mund te kerkohet ndalimi i nje veprimi qe nuk ka ndodhur dhe qe nuk mund te ndodh kurre.

Ne piken 5 te objektit te kunderpadise, kunderpaditesi kerkon te ndaloje shoqerine *** shpk te prodhoje ekportoje impoertoje, shperndaje, hedh ne treg, ofroje per shitje,

magazinoje, reklamoje dhe amballazhoje produktet e tij me etiketen e markes ***...Ky kerkim eshte ne fakt nje kerkim qe perbledh kerkimet e bera ne piken 3 dhe 4 te objektit te kunderpadise. Pra kemi perseritje te kerkimeve ne disa pika te objektit te kunderpadise. Ne piken 5 te objektit, kemi nje kerkim kumulativ, duke perfshire te gjitha ciklin e nje produkti, duke filluar nga prodhimi, ekporti, importi, shpendarja, hedhja ne treg, magazine, reklame dhe amballazh. Rezultoi nga ekstrakti i QKB se shoqeria *** nuk eshte shoqeri prodhuese, nuk kryen eksporte, aq me teper te produkteve te markes ***, nuk e ka fare ne objektin e aktivitetit te saj perdorimin e produkteve me etiken e markes ***, asnjehere qe me fillimin e aktivitetit deri me sot.

Ne lidhje me piken 6 te objektit te kunderpadise "Bllokimi dhe shkaterrimi me shpenzimet e pales se kunderpaditurit, te te gjitha produkteve te miellit ***, te prodhuara dhe te shpendara ne tregun shqiptar nga *** shpk", ky kerkim eshte pa kuptim, pasi kerkohet nga prodhuesi/eksportuesi qe te shkaterrohet produkti i prodhuar nga ai vete dhe i importuar me kontrate furnizimi kundrejt nje marredhenie disavjecare. Ky lloj kerkimi nese eshte qellim i kunderpaditesit *** shpk, mund te ndalohet nga ai vete nepermjet mosfurnizimit te shoqerise *** shpk me produktet ***. Rezulton fakt qe *** shpk, ndonese e furnizon *** shpk, me miell *** me pas kerkon bllokim dhe shkaterrim te mallit te prodhuar nga ai vete (*** shpk).

Ne lidhje me piken te 7 te objektit te kunderpadise, ku kerkohet "Ndalimi i veprimeve te konkurences se pandershme nga shoqeria *** shpk dhe mosperseritja e veprimeve te tilla ne te ardhmen", perseri jemi para nje kerkimi te paqarte, pasi termi veprime te konkurences se pandershme duhet te specifikohet se cilat jane veprimet konkrete qe kerkohet te ndalohen ne kuadrin e konkurences se pandershme, nga shoqeria *** shpk.

Ne permbajtje te kunder-padise (faqen 4 te saj) kerkohet qe markat tregtare *** *** me Nr regjistrimi 15370, 15371 dhe 15372 te shfuqizohen bazuar ne nenin 172 (1) (b) te ligjit Nr.9947. Baza ligjore e perdorur per kete kerkim nuk perfshihet fare ne bazen ligjore te Kunderpadise, por edhe po te ishte perfshire, do te ishte e pakuptimte pasi dispozita e referuar nga kunderpaditesi ka te beje me heqjen dore nga pronari i markes dhe jo me kerkimin per shfuqizim ne gjykate.

Faktet e pretenduara ne Kunderpadi se paditesi/i kunderpaditur, shoqeria "**** " sh.p.k ka vene ne levizje gjykatën pasi Pala e Paditur/Kunderpaditese ka paraqitur kerkese per shfuqizim marke *** *** ne DPPI rezultuan te paverteta pasi efektivisht: Aktet; - Kerkesa e paditesit me Nr. *** date *** drejtuar DPPI, me objekt "kerkohet refuzimi i kerkesesave per regjistrim per markata tregtare *** tre kerkesa te reja per regjistrim tek DPPI". - Kerkese per hetim administrativ per marken *** ose te ngjashme me te, drejtuar DPPI date *** me nr.prot ***. - Shkresa Nr. *** date *** e DPPI, me lende "Njoftim". -Kerkesa me NR.Prot *** date *** drejtuar Administrates Doganor per mbrojtjen e te drejtave te pronesisë industriale, te gjitha jane bere perpara dates ***.

Kerkesa per shfuqizim e dates 02. 02. 2018, e paraqitur nga kunderpaditesi, eshte mardhenie e kunderpaditesit me DPPI dhe pretendimi qe paditesi eshte vene ne levizje nga kjo kerkese, eshte i pambeshtetur jo vetem per shkak te shkresave te listuara me siper por edhe faktit e mungeses se marrjes dijeni nga paditesi per marredhenien qe ka kunderpaditesi me nje pale te trete (me argumentimin qe ka bere, kunderpaditesi paditesi njehsohet me DPPI) qe ne fakt eshte pale e paditur ne kete proces.

*Per te gjitha sa me lart, me cilesine e pronarit te markes “*** **”, shoqeria “***” shpk, kerkoi nga gjykata, qe te vendose pranimin e padise se paraqitur nga Paditesi i Kunderpaditur, shoqeria *** sh.p.k, sipas objektit te saj dhe rrezimin e kunder-padise.*

*Nga ana e saj pala e paditur kunderpaditese shoqeria “***” sh.p.k. prapsoi ne gjykim se Shoqëria *** është një shoqëri tregtare e mirënjohur në Kosovë, në Shqipëri dhe rajon në fushën e prodhimit, tregtimit, shitjes, ofrimit për shitje, eksportit dhe importit të miellit, grurit dhe produkteve të tjera ushqimore.*

**** është furnizues ndërkombëtar dhe prodhuesi më i madh në rajon i miellit nga gruri me cilësi të lartë. Aktualisht, *** ka mbi *** të punësuar, të cilët angazhohen me përgjegjësi të lartë për përmbushjen e nevojave unike të konsumatorëve. Kapaciteti ditor i përpunimit të grurit është 600 ton, nga të cilat prodhohet miell sipas standardeve më të larta ISO dhe HACCP duke përfshirë standardin më të lartë në botë të sigurisë ushqimore FSSC 22000, IFS dhe BRC.*

**** udhëheq tregun e Kosovës me furnizime të miellit me shumicë dhe pakicë, si dhe shumicën e furrave të bukës. Përveç shitjeve të brendshme në Kosovë, si prodhues kryesor i miellit të grurit në rajon, *** eksporton edhe në vende të ndryshme në rajon dhe në botë, duke përfshirë Shqipërinë.*

*Në këtë kuadër, *** ka lidhur një seri marrëveshjesh bashkëpunimi me shoqëri ndërkombëtare shumë të njohura, si ***, duke përmbushur njëkohësisht të gjithë standartet e nevojshme për t’u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar ***. Gjithashtu, *** është regjistruar në Administratën e Ushqimit dhe Barnave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (FDA) për të eksportuar miell në SHBA në përputhje me Aktin Federal të Ushqimit dhe Barnave të SHBA-s.*

*Produktet e ***-t, sipas çertifikimeve përkatëse, eksportohen gjithashtu në territorin e Bashkimit Europian, duke përfshirë shtete të tilla si: Gjermani, Zvicër, Suedi, Belgjikë, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Austri, etj. Mbi të gjitha, theksojmë këtu se, shoqëria “***” furnizon me miell Misionin e OKB-së në Minusca, Bangui, Republikën e Afrikës Qendrore dhe Minusma. *** është certifikuar në sistemet më prestigjioze të sigurisë së ushqimit në botë, siç janë: FSSC 2000, IFS dhe BRC.*

**** ka zhvilluar një gamë të gjerë të produkteve të miellit duke angazhuar një staf profesional, teknologji të fundit në këtë industri, si dhe aplikimin e standardeve më të larta të sigurisë dhe kualitetit gjatë procesit të prodhimit të miellit. Ndër produktet më të mirënjohura dhe me reputacion tejet të lartë të shoqërisë “***”, është padyshim mielli që tregtohet nën brandin/markën tregtare “***”.*

*Më konkretisht, shoqëria “***” prodhon, hedh në treg dhe eksporton miell nën brandin/markën “***” në lloje, forma dhe paketime të ndryshme si *** Tip 400, *** Tip 500, *** Tip 1000, *** Tip Premium, *** Integral, etj...*

*Në mbështetje të aktivitetit të saj, në vitin 2012 (më shumë se 1 vit më përpara se sa të depozitoheshin në DPPI aplikimet për regjistrim të markave “***, ***”), *** ka regjistruar fillimisht në Agjencinë e Pronësisë Industriale të Kosovës markat tregtare “***” me të dhënat e mëposhtme:*

Marka tregtare

Numri i aplikimit
Numri i regjistrimit
Datë depozitimi
Klasa
Datë e mbarimit të mbrojtjes

*Marka fjalë & figurë është regjistruar edhe si markë më vete, si dhe karakterizon të gjithë paketimet e produkteve të miellit të shoqërisë “***”.*

*Markat tregtare (fjalë & figurë) të sipërpërmendura përbëjnë vetëm një pjesë të portofolit të markave tregtare “***” që janë regjistruar për herë të parë nga shoqëria “***”.*

*Krahas regjistrimeve fillestare të markave tregtare “***” për mallrat e klasës 30 të Klasifikimit Ndërkombëtar të Nicës, *** (nëpërmjet shoqërisë së lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të - *** ka regjistruar pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) markat tregtare “***” me të dhënat e mëposhtme:*

Marka tregtare
Numri i regjistrimit
Datë regjistrimi
Klasa
Datë e mbarimit të mbrojtjes

*Marka fjalë & figurë është regjistruar edhe si markë më vete, si dhe karakterizon të gjithë paketimet e produkteve të miellit të shoqërisë “***”.*

*Së fundmi, në mënyrë që të mbrohet nga veprimet e kokurrencës së pandershme të shoqërisë “***” shpk, shoqëria *** ka regjistruar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje të plotë me ligjin 9947 markën tregtare “*** ***” me numër regjistrimi ****

Lista e mallrave dhe/ose e sherbimeve

Kafja, çaji, kakaoja, sheqeri, orizi, tapioka, sagu, kafja artificiale; mielli dhe gatitjet prej drithërave, buka, brumërat dhe ëmbëlsirat, akulloret; mjalti, melasa; tharmi, pluhuri për pjekje, kripa, mustarda; uthulla, salcat (kondimentet); erëzat

*Marka tregtare “*** ***” është publikuar fillimisht në buletin zyrtar të Pronësisë Industriale (Marka tregtare dhe diseno industriale), duke i krijuar mundësi çdo personi të interesuar të kundërshtojë regjistrimin e markës bazuar mbi të drejta të mëparshme. Kjo mundësi nuk është shfrytëzuar nga paditësi, pavarësisht se ai ka qenë vazhdimisht i vëmendshëm ndaj aplikimeve të kryera nga shoqëria ***.*

*Për më tepër, marka në fjalë nuk është kundërshtuar as pas regjistrimit të saj në regjistrin e markave tregtare. Kërkesa për shfuqizimin e markës “*** ***” me numër regjistrimi *** është paraqitur nga paditësi drejtpërdrejt në gjykatë vetëm pasi ka marre*

dijeni mbi depozitim e kërkesave të shoqërisë *** për shfuqizimin e markave “***, ***” si marka të aplikuara në kushtet e keqbesimit.

Sa më sipër, shoqëria “***” gëzon një reputacion tejet të lartë dhe ka arritur suksese të shumta në fushën e veprimtarisë tregtare në vijim edhe të eksperiencës së saj të gjatë në prodhimin dhe tregtimin e miellit. Në këtë kuadër, shoqëria “***” ka lidhur një seri marrëveshjesh bashkëpunimi në forma të ndryshme, kryesisht në formën e kontratave të furnizimit, me mjaft shoqëri vendase dhe të huaja. Një prej shoqërive që ka bashkëpunuar për një periudhë të gjatë kohe me “***” është edhe shoqëria shqiptare “***”.

Në këtë kontekst, ndërmjet shoqërisë ***, si prodhues i produkteve të miellit “***” dhe pronar i markës me të njëjtin emër dhe shoqërisë ***, në cilësinë e distributorit dhe blerësit të mallit/produktit miell “***”, ka ekzistuar një marrëdhënie bashkëpunimi tregtar prej një periudhe shumë të gjatë kohe.

Më konkretisht, *** dhe *** kanë lidhur ndër vite një seri kontratash furnizimi midis tyre në lidhje me shitëblerjen e mallrave/produkteve të miellit “***”. Fillimi i bashkëpunimit tregtar ndërmjet dy shoqërive-palë ndërgjyqëse në këtë gjykim dhe lidhja e kontratave të furnizimit dhe shitë-blerjes ndërmjet tyre daton më shumë se një dekadë më parë, pra shumë më përpara në kohë se shoqëria *** të aplikonte në keqbesim për regjistrimin e markave “***”.

Natyrisht, pronar i mallrave/produkteve dhe brand-it/markës “***” ishte dhe vazhdon të jetë ***, fakt që është pranuar edhe nga vetë paditësi kur ka nënshkruar me pëlqim të lirë e të plotë kontratat mbi shitë-blerjen e mallrave, miell dhe hime të administruara si prova në gjykim, ku parashikohet shprehimisht se: “Shitësi është pronar i produkteve dhe brandeve “*** dhe “***”, si produkte primare, si dhe posedon sasi të konsiderueshme të Himeve si produkte sekondare; Ndërsa Blerësi është klient i rregullt i shitësit dhe i cili distribuon produktet e shitësit për tregun e Republikës së Shqipërisë.”.

Gjithashtu, vetë shoqëria “***” sh.p.k., në një letër zyrtare drejtuar Ministrinë të Bujësisë të Republikës së Shqipërisë mbi çështjen e importit të miellit nga Kosova, pohon se: “Ne si kompani, *** shpk, jemi distributorë ekskluzivë për Shqipëri të produkteve të fabrikës së përpunimit të grurit, respektivisht fabrika për prodhimin e miellit *** nga Kosova me brende “***” dhe ***, që nga viti 2008.”

Për më tepër, në kërkesë-padinë e tij drejtuar gjykatës, vetë shoqëria ***, referuar paragrafëve që citohen nga kjo kërkesë-padi, pranon disa herë dhe në mënyrë të përsëritur se prodhues dhe pronar i miellit “***” është shoqëria ***. Konkretisht: “Më pas kemi vijuar normalisht aktivitetin me furnizim nga prodhuesi, kompania “***” sh.p.k. Kosovë me miell gruri tip ***” (Paragrafi 4, faqe nr. 3 e kërkesë-padisë);

“...Në çdo rast, eksportuesi është *** sh.p.k. Kosovë.” (Paragrafi 5, faqe nr. 3 e kërkesë-padisë);

“Për më tepër, prodhimi i amballazhit për miellin e grurit Tip *** (thasëve për paketimin e mallit Miell Gruri tip ***), bëhej nga vetë prodhuesi kompania *** sh.p.k. tek Kompania Shqiptare *** sh.p.k.” (Paragrafi 6, faqe nr. 3 e kërkesë-padisë);

“....të dyja shoqëritë e përdorin këtë emër (***) , për të tregtuar të njëjtin mall miell gruri që prodhohet nga i njëjti prodhues “***” shpk dhe që ka të njëjtën origjinë, nga Kosova” (Paragrafi 3, faqe nr. 5 e kërkesë-padisë);

“.....mallrat e tregtuar nën këto marka tregtare kanë një prodhues dhe një origjinë.

*Prodhuesi është shoqëria “***” shpk me adresë ***” (Paragrafi 1, faqe nr. 6 e kërkesë-padisë);*

*Në vijim të lidhjes së kontratave të furnizimit dhe shitëblerjes së mallrave, *** shpk ka pasur detyrimin që të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme për furnizimin e tregut shqiptar me mallrat e miellit “***” të shoqërisë “***”. *** mund të ketë kryer investime të konsiderueshme në tregun shqiptar, qoftë edhe duke kontribuar në ndërtimin e tregut për mallrat e markës “***”, por ai nuk gëzon asnjë të drejtë për të aplikuar në mënyrë të paautorizuar për regjistrimin e markës “***” në emër të tij.*

*Investimet monetare e konsiderueshme të shoqërisë *** për krijimin e një segmenti të caktuar të tregut dhe furnizimin e tij me mallrat e markës “***” janë detyrime kontraktore të palës distributore në kuadër të marrëdhënies së bashkëpunimit tregtar që është materializuar nga lidhja e kontratave të furnizimit. Këto veprime janë në interes të drejtpërdrejtë të distributorit, i cili në këtë mënyrë përfiton avantazhe ekonomike edhe më të mëdha. Në çdo rast, distributori thjesht përmbush detyrën e tij duke investuar në reklamimin dhe ndërtimin e një tregu sa më të gjerë.*

*Në rast se pala distributore nuk do të ushtronte në mënyrë të suksesshme detyrën e saj kontraktore, atëherë furnizuesi (“***”) do të zgjidhte kontratën e tij me *** dhe do të lidhte një kontratë furnizimi me subjekte tregtare të tjerë në mënyrë që të rritej vëllimi i shitjeve të produkteve të tij. Në asnjë rast të vetëm, distributori i shoqërisë prodhuese dhe furnizuese të mallrave nuk mund të aplikojë në mënyrë të paautorizuar për regjistrimin e markës që mbajnë këto mallra në emër të tij.*

Pra, distributori ka për detyrë të sigurojë furnizimin e tregut ku ai vepron me mallrat e furnizuesit dhe të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron të arsyeshëm e të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së tij tregtare, por ai nuk mund kurrësesi të pretendojë pronësinë mbi markën e këtyre mallrave.

Shoqëria *** ka regjistruar në DPPI markat tregtare “****” me të dhënat e mëposhtme:

Marka:

Për sa më sipër, rezulton shumë qartë se është paditësi ai që ka shkelur të drejtat e pronësisë industriale të të paditurit-shoqërisë *** dhe jo e kundërta. Konkretisht, paditësi ka shkelur jo vetëm dispozitat e Ligjit 9947, por edhe nenin 638 të Kodit Civil duke kryer veprime të kundraligjshme që përbëjnë konkurrencë të pandershme.

Kështu, shoqëria *** ishte në dijeni të plotë dhe pranon se pronari dhe prodhuesi i produkteve të miellit me shenjën/markën “****” ishte shoqëria ***. Pra, shenja dhe emri dallues “****” për produktet e miellit i përket shoqërisë ***. Ky fakt është konfirmuar edhe nga vetë shoqëria ***, siç u tha më sipër, duke nënshkruar kontratat e distribucionit me shoqërinë ***.

Në këto kushte, shoqëria ***, duke regjistruar në emër të saj markat *** të shoqërisë ***, ka përdorur dhe poseduar në mënyrë të paautorizuar shenjën dhe emrin dallues *** të shoqërisë ***. Rrjedhimisht, shoqëria ***, aplikimet për regjistrimin e markave *** i ka bërë në keqbesim. Një veprimtari e tillë përfshihet në fushën e veprimeve të konkurrencës së pandershme që parashikohen shprehimisht në nenin 638 të Kodit Civil.

Për më tepër, në janar të vitit 2018, shoqëria “****” ka parashtruar pranë shoqërisë “****” një kërkesë për kthimin e mjeteve të parapaguara për miellin me arsyetimin se nuk e pranon ambalazhin e ri të prodhuar nga shoqëria “****”. Pavarësisht për sa më sipër, *** ka vazhduar të tregtojë miellin “****” me të njëjtin ambalazh identik si më parë, duke zëvendësuar vetëm emrin e prodhuesit “****” me emrin e shoqërisë “****” (kjo sipas pamjeve fotografike të ambalazhimit të produktit tëmiellit “****” që është tregtuar nga shoqëria “****” nën shenjën dalluese/markën e saj, si dhe të produktit të miellit “****” që tregtohet nga shoqëria “****”), çka përbën një veprim të pastër të konkurrencës së pandershme që dëmton edhe më shumë markën “****” të shoqërisë “****”.

Dëmi ekonomik dhe moral që pëson shoqëria “****” është edhe më i madh, edhe për faktin se produktet e miellit të shoqërisë “****” janë denoncuar publikisht në mediane publike si produkte të tregtuara në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Madje, për këtë rast, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka depozituar edhe një kallzim penal pranë organeve kompetente kundrejt shoqërisë “****” dhe përfaqësueve të saj. Padyshim, denoncimi publik në media dhe regjistrimi i një procedimi penal ndaj shoqërisë “****” sjell një dëm shumë të madh ekonomik dhe imazhi për shoqërinë “****”.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, është e mjaftueshme që të vërtetohet vetëm fakti i kryerjes së veprimeve të konkurrencës së pandershme në mënyrë që gjykata të vendosë ndalimin e veprimeve të tilla dhe ndërmarrjen e masave përkatëse për të zhdukur pasojat e ardhura. Gjithësesi, paditësi/i kundërpaditur ka shkelur në mënyrë flagrante dispozitat ligjore të ligjit 9947.

Aplikimet për regjistrimin e markave tregtare “****” me numër regjistrimi ***, *** dhe *** janë bërë në keqbesim të hapur, dhe si rrjedhojë, këto marka duhet të shfuqizohen në përputhje me nenin 173(1)(b) të Ligjit 9947 dhe po kështu pas këtij shfuqizimi, për të mbrojtur tashmë në vijim marken e regjistruar nga ana e të paditurit duhet të pranohen dhe kerkimet e tjera të objektit të kunder-padise siç citohen në pjesën hyrëse të vendimit.

Nga ana e saj përfaqësuesja e pales së paditur në kerkese-padi dhe kunderpadi DPPI, shprehu në konkluzionet perfundimtare se regjistrimi i markave respektive nga të dy subjektet ndergjyqese është bërë në përputhje me percaktimet ligjore të Neneve 145-154 të ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 me ndryshimet, nisur kjo dhe nga fakti se askush nga subjektet e interesuara brenda periudhës së kundështimit nuk ka kundështuar regjistrimin e markave respektive të njeri-tjetrit.

Arsyetimi i gjykates.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazës ligjore të kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm

brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Perpos kesaj referuar pretendimit paraprak te pales se paditur per mos sakesimin e bazes ligjore te padise, referuar parimeve procedurale te siperperemendura, pare ne harmoni dhe me konkluzionet e vendimin unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykeses se Larte Nr. 3 dt. 29. 03. 2012 lidhur me bazen ligjore te kerkese–padise gjykata nisur nga parimi ius novit curia (gjykata e njeh ligjin) çmon se ne rastin konkret shkaku ligjor i kerkese–padise eshte i qarte dhe i kuptueshem ne lidhje me objektin e kerkimit te pretenduar. Sipas ketij vendimi eshte unifikuar se : gjykata e zbulon shkaku e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesë-padisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkaku që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesë-padisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

Në lidhje me sa u parashtrua më sipër, nisur dhe nga keto percaktime procedurale për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata çmon se është e nevojshme të zgjidhen çështjet juridike si vijon:

Cili është standardi i provueshmërisë në rastin e gjykimit të mosmarrëveshjeve në lidhje me regjistrimin e markave që shkaktojnë konfuzion me markat e tjera të regjistruara më parë?

A jemi ne kushtet e keqbesimit per regjistrimin e markes ***, *** nga shoqeria **** sh.p.k.?

A jemi perpara konkureses se pandershme per shkak te produkteve te tregtuara nga palet ndergjyqese ?

Nisur nga keto çeshtje per diskutim, gjykata vlerëson se standardi i të provuarit në mosmarrëveshjen objekt gjykimi, kërkon që pala paditëse të provojë regjistrimin e mëparshëm të markës së saj, si dhe regjistrimin e mëvonshëm të markës së pretenduar se krijon konfondim (ngatërrimit) me markën e mëparshme. Po ashtu, nga provat e paraqitura gjatë gjykimit, duhet të krijohet bindja se ekziston mundësia e konfondimit dhe jo vetë konfondimi. Mundësia e konfondimit është element që perceptohet nëpërmjet ushtrimit të një gjykimi sipas standardit mesatar të vlerësimit të një konsumatori në vendin dhe kohën në të cilën ndodh mosmarrëveshja. Vlerësimi i mundësisë së konfondimit, në kundërshtim sa pretendon pala e paditur, nuk mund të provohet me ekspertë, për faktin e vetëm se nuk ekzistojnë ekspertë në këtë fushë. Siç u tha, kriteri i vlerësimit është subjektiv dhe bazohet në vlerësimin e ndershem të mundësisë që një konsumator mesatar, të konfondohet nga dy markat tregtare në fjalë. Mundësia e konfondimit është e vlerësueshme potencialisht, me një gjykim të arsyeshëm paraprak dhe për rrjedhojë mbi palën paditëse nuk rëndon barra që të provojë ekzistencën aktuale të konfondimit të konsumatorit.

Në rastin konkret, duke marrë për bazë dy markat që i nënshtrohen gjykimit, gjykata vlerëson në mënyrë abstrakte, nëse ka mundësi që të krijohet konfuzion midis dy markave.

Pra palët kanë detyrimin dhe barrën të provojnë plotësisht ekzistencën e të drejtave mbi markat e regjistruara, por jo edhe të provojnë mundësinë e konfuzionit të konsumatorit, pasi kjo vlerësohet në mënyrë abstrakte nëpërmjet vlerësimit të atyre kriterëve që shërbejnë për përcaktimin nëse një markë është e ngjashme me një tjetër apo jo. Në vlerësimin e fakteve objekt gjykimi, gjykata mban parasysh në vlerësimin e kriterëve të përcaktuara në ligjin e brendshëm (p.sh: neni 143 i ligjit “Për pronësinë industriale) edhe konventat ndërkombëtare, si edhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Europiane, apo manualët e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (duke mbajtur parasysh këtu edhe ligjin nr. 8993, datë: 30.01.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale”). Kjo pasi gjykata i vlerëson këto të fundit, si burime autoritare, për interpretimin e kriterëve dhe për vlerësimin e fakteve objekt gjykimi, sipas praktikës më të mirë ndërkombëtare.

Ne vijimesi ne arsyetimin e meposhtem, keto çeshtje per diskutim marrin pergjigje per sa vijon. Keshtu, ne lidhje me kerkese-padine gjykata vlereson se krahas argumenteve të parashtruara në kundër-padinë e paraqitur nga pala e kunderpaditur, padia e paraqitur nga paditësi është terësisht e pambështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë, ajo duhet të rrëzohet për arsytet sa më poshtë.

Së pari, vetë paditësi pranon dhe thekson në kërkesë-padinë e tij që prodhuesi i produkteve/mallrave të miellit “****” është shoqëria “****” shpk. Në mënyrë të përsëritur, paditësi përmend faktin se këto produkte/mallra kanë origjinë nga Kosova. Në këtë kuptim, ligji 9947 përcakton si markë tregtare çdo shenjë të regjistrueshme që tregon origjinën tregtare të mallrave, duke bërë të mundur dallimin midis mallrave të një personi nga ato të një tjetri.

Shenja dhe emri “****” apo “****” është një shenjë dhe emër që lidhet ngushtësisht me produktet e miellit të shoqërisë “****”. Kjo shenjë dhe ky emër janë përdorur ligjërisht nga shoqëria “****” për produktet e miellit, duke fituar një karakter dallues tepër të lartë në rradhët e konsumatorëve dhe publikut të gjerë.

Paditësi, duke përfituar nga marrëdhëniet e bashkëpunimit tregtar me të paditurin, në cilësinë e distributorit të produkteve të miellit “****”, ka shkelur të gjithë parimet dhe praktikatat e ndershme të biznesit/tregtisë duke aplikuar për regjistrimin e kësaj marke në DPPI në kushtet e keqbesimit të pastër. Në këtë aspekt, veprimet e ndërmarra nga paditësi përbëjnë qartazi veprime të konkurrencës së pandershme, veprime të cilat ndalohen dhe sanksionohen shprehimisht nga neni 638 i Kodit Civil.

Në këtë kuadër, theksohet fakti se i padituri ka regjistruar fillimisht markën “****” pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale të Kosovës më datë 03.10.2012 (14 muaj më përpara në kohë se aplikimet për regjistrimin e markave “****, ****” në DPPI), duke qenë se Kosova është edhe vendi ku “****” ushtron veprimtarinë e tij kryesore dhe ka selinë e shoqërisë. Pavarësisht për sa më sipër, duke aplikuar dhe regjistruar në keqbesim markat tregtare “****, ****”, paditësi njëherazi ka krijuar vështirësi dhe pengesa të mëdha për shoqërinë “****”. Kjo pasi, të paditurit i janë refuzuar nga DPPI-ja 17 aplikime për regjistrimin si markë të shenjës dhe emrit të tij dallues: “****”, me argumentin se një markë tregtare tjetër me emrin “****” figuron e regjistruar pranë DPPI-së për mallrat e klasës 30 të Klasifikimit të Nicës. Në këtë drejtim, shoqëria *** me te drejte ka regjistruar markën “**** ****” me numër regjistrimi ***

në DPPI dhe kjo thjesht dhe vetem si një mjet mbrojtës ndaj veprimeve të konkurrencës së pandershme të shoqërisë *** dhe markave “***, ***” të aplikuara në keqbesim nga ky i fundit.

Në vijim për sa më sipër, i padituri ka depozituar pranë DPPI-së edhe kërkesat për shfuqizimin e markave “***, ***” në përputhje me nenin 173 (1) (b) të ligjit 9947.

Marka “*** ***” nuk është kundërshtuar asnjëherë gjatë fazës së publikimit të saj apo edhe më vonë nga paditësi, por kërkesa për shfuqizimin e saj është paraqitur pranë gjykatës vetëm në momentin që paditësi mori dijeni mbi depozitimin e kërkesave për shfuqizim të markave të tij “***, ***”.

Në këtë mënyrë, kronologjia e ngjarjeve të përshkruara më sipër, ashtu si edhe rrethanat, provat dhe faktet e paraqitura pranë gjykatës, rrëzojnë çdo pretendim të paditësit rreth qëllimit dhe veprimeve keqdashëse të shoqërisë “***” shpk për të regjistruar si markë për produktet e miellit të grurit shenjën “***”.

E drejta legjitime e shoqërisë “***” mbi prodhimin, tregtimin dhe eksportimin e miellit “***” është pranuar edhe nga vetë paditësi në momentin e depozitimit të kërkesës për veprim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe e miratuar prej saj nëpërmjet vendimit nr. protokollit ***, datë ***. Për sa më sipër, ky vendim përbën një tjetër provë në mbështetje të pretendimeve të paditurit, pasi, rezulton qartë se shoqëria “***” sh.p.k. ka qene në dijeni të plotë dhe pranon shprehimisht faktin se prodhuesi i vetëm legjitim i mallrave të miellit nën shenjën/markën “***” është shoqëria “***” sh.p.k.

Gjithashtu, shoqëria “***” siguron prodhimin e ambalazhit të produkteve të miellit “***” për çdo distributor të saj në vendet e rajonit. Një politikë e tillë është ndjekur nga shoqëria “***” edhe në vende të tjera të rajonit, duke vendosur në ambalazh markën e saj “***” (dhe jo markën “***, ***”) dhe të dhënat e importuesit/distributorit përkatës.

Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (i ndryshuar), prodhuesi i mallrave ka detyrimin ligjor që të shënojë të dhënat përkatëse mbi karakteristikat e mallrave dhe kushtet e tregtimit të tyre në etiketën/ambalazhin e mallit. Në këtë kuptim, emri i distributorit/importuesit të mallrave duhet detyrimisht të shënohet në etiketën/ambalazhin e mallrave përpara hedhjes së tyre në treg, por një parashikim ligjor i tillë nuk sjell si rrjedhojë faktin se pronari i markës së këtyre mallrave është distributori/importuesi.

Pretendimet e paditësi se kërkesa për regjistrimin e markës “*** ***” dhe regjistrimi i saj është bërë në keqbesim dhe rrjedhimisht kjo marke duhet të shfuqizohet rezultoi për gjykatën e pambështetur në ligj dhe në prova, për faktin se:

Paditësi nuk solli asnjë argumentim ligjor apo provë konkrete që të vërtetojë ekzistencën e keqbesimit në aplikimin për regjistrim të markës “*** ***”. Shenja dhe emri “***” apo “***” është një shenjë/emër që i përket në mënyrë të padiskutueshme shoqërisë “***” dhe që është përdorur ligjërisht nga kjo shoqëri prej më shumë se 15 vitesh. Një fakt i tillë është pranuar shprehimisht edhe nga vetë paditësi.

Keqbesimi konsiston në një sjellje që devijon nga parimet e njohura dhe të pranuarat të sjelljes etike apo praktikave të ndershme të biznesit dhe tregtisë. Për të përcaktuar nëse aplikimi për regjistrim i markës është bërë në keqbesim, duhet të medoemos të vërtetohet fakti se pronari i markës së regjistruar në keqbesim synon të përfitojë dhe të përdorë në

mënyrë të paautorizuar e të pandershme një shenjë dalluese apo markë që në fakt i përket një personi tjetër.

Në rastin konkret, ky pretendim i paditësit rreth ekzistencës së keqbesimit nga ana e shoqërisë “****” gjatë aplikimit për regjistrim marke “**** ****” në DPPI, bie poshtë dhe nuk qendron në asnjë moment duke konsideruar faktet dhe provat e paraqitura përpara gjykatës në lidhje me këtë çështje.

Per gjykatën: Nuk mund të flitet për keqbesim në aplikimin për regjistrim marke “**** ****” kur provohet dhe pranohet nga të dy palët ndërgjyqëse (paditësi/i kundërpaditur dhe i padituri/kundërpaditës) që shoqëria “****” prodhon dhe tregton produktet e miellit “****”/”****”.

Nuk mund të flitet për keqbesim në aplikimin për regjistrim marke “**** ****” kur të dy palët ndërgjyqëse (paditësi/i kundërpaditur dhe i padituri/kundërpaditës) pohojnë se origjina tregtare e mallrave të miellit “****” është nga Kosova. Nuk mund të flitet për keqbesim kur vetë paditësi, me pëlqimin e tij të lirë dhe me vullnet të plotë, pranon dhe deklaron se shoqëria “****” është pronare e produkteve dhe brandeve/markave tregtare “****”.

Provohet gjyqësisht se për herë të parë, marka “****” është regjistruar nga shoqëria “****” në Agjencinë e Pronësisë Industriale të Kosovës. Një shenjë e tillë përdorej dhe vazhdon të përdoret rregullisht e ligjërisht nga i padituri për produktet/mallrat e miellit prej më shumë se 15 vitesh, duke fituar një karakter dallues dhe reputacion tejet të lartë në rradhët e konsumatorëve dhe publikut përkatës. Paditësi ka qenë i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në një marrëdhënie të bashkëpunimit tregtar me të paditurin, në cilësinë e distributorit të miellit “****”, duke lidhur një seri kontratash të vazhdueshme furnizimi dhe shitë-blerjeje.

Pra, paditësi ka qenë në dijeni dhe ka pranuar se prodhuesi dhe pronari i miellit të markës “****” është shoqëria “****”. Pavarësisht këtij fakti, paditësi ka aplikuar dhe regjistruar në mënyrë të paautorizuar dhe në keqbesim të pastër markat “****, ****” me numra regjistrimi ***, ***, dhe ***.

Pyetjet që shtohen në këto rast janë se: A është e mundur dhe e drejtë që distributori në një marrëdhënie të bashkëpunimit tregtar të regjistrojë në mënyrë të paautorizuar në emër të tij një markë tregtare që i përket qartësisht furnizuesit/prodhuesit dhe më pas të kërkojë ndalimin e përdorimit të kësaj marke nga furnizuesi dhe prodhuesi i mallrave? Si mund të flitet për keqbesim në aplikimin për regjistrim të një marke që është përdorur ligjërisht dhe në mënyrë të vazhdueshme nga pronari i saj më përpara në kohë se markat e kërkuarit? Si mund të flitet për keqbesim në aplikimin për regjistrim të një marke që përbën shenjën dhe emrin dallues të produkteve të miellit të prodhuara dhe të tregtuara prej shumë vitesh nga pronari i saj?

Në çdo rast, është e pakonceptueshme dhe e pakuptimtë që të flitet për ekzistencën e keqbesimit në momentin e aplikimit të markës “**** ****”, duke argumentuar se shoqëria “****” ka aplikuar 17 herë për regjistrim marke në një kohë që vazhdonte të furnizonte me miell gruri “****” shoqërinë “****”.

I padituri, pronari legjitim dhe i vërtetë i shenjës dalluese/markës “****” që prodhon prej më shumë se 15 vitesh produktet e miellit nën të njëjtën shenjë/markë, nuk ka asnjë detyrim që të lajmërojë apo të vëjë në dijeni distributorin apo çdo person tjetër mbi aplikimet

e mundshme për regjistrim marke që ai bën apo mund të bëjë.

Mos berja e nje veprimi te tille, nuk mund dhe nuk ka se si të tregojë apo të vërtetojë ekzistencën e keqbesimit. Nga sa më sipër, rezulton se edhe pretendimi i paditësit mbi qëllimet jo të mira dhe tendencioze të shoqërisë “****” për të dëmtuar biznesin e tij, është i pambështetur në fakte, ligj e në prova. Si rrjedhojë, gjykata konkludon se kërkesa për shfuqizim të markës “**** ****” është e pabazuar në ligj e në prova.

Paditësi nuk ka paraqitur asnjë argument ligjor në mbështetje të pretendimeve të tij për të vërtetuar ekzistencën e keqbesimit në momentin e aplikimit për regjistrim të markës “**** ****” me numër regjistrimi ***.

Nisur nga ky këndvështrim, asnjë nga argumentet e paraqitura nga paditësi në kërkesë-padi nuk vërtetojnë ekzistencën e keqbesimit dhe as nuk kanë fare lidhje me nocionin e “keqbesimit”, por përkundrazi, personi që ka aplikuar në keqbesim markat e tij është paditësi.

Paditësi pretendon se marka “**** ****” duhet të deklarohet e pavlefshme nga DPPI-ja sepse cënon haptazi të drejtat e markës së regjistruar më parë nga shoqëria “****” shpk, pasi pjesa thelbësore e dy markave është e njëjtë. Në arsyetimin e tij, paditësi bazohet në nenin 143 të ligjit 9947: refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe relative.

Per gjykatën ky pretendim nuk qendron pasi, neni 143 i ligjit 9947 ku paditësi mbështet pretendimin e tij, nuk mund të zbatohet nga DPPI-ja pa u vënë paraprakisht në lëvizje nga një person i interesuar. Pra, DPPI-ja nuk mund të deklarojë të pavlefshme një markë gjatë ekzaminimit të aplikimit duke u bazuar në nenin 143 të ligjit 9947. DPPI-ja bën ekzaminimin e një aplikimi për markë vetëm bazuar mbi shkaqet absolute të parashikuara nga neni 142 i ligjit 9947, dhe jo mbi shkaqet relative të parashikuara nga neni 143 i këtij ligji.

Gjithësesi, çdo pretendim i ngritur nga paditësi në lidhje me ekzistencën e të drejtave të mëparshme të tij, bie automatikisht poshtë persë kohe u vërtetua se aplikimet për regjistrim të markave “****, ****” janë bërë në keqbesim dhe shfuqizimi i markave “****, ****” të shoqërisë “****” shpk përbën edhe objektin kryesor të kundërpadisë së depozituar nga shoqëria “****”.

Paditësi pretendon se kërkesa e tij bazohet në të drejtat që rrjedhin nga neni 156 i Ligjit 9947. Sipas tij, shoqëria “****” është në kushtet e konkurrencës së pandershme sepse ka kërkuar të regjistrojë një produkt të mbrojtur me të cilin furnizonte shoqërinë “****”.

Edhe ky pretendim i paditësit është i pambështetur në ligj dhe në interpretim të gabuar të ligjit material. Konkretisht, neni 156 i ligjit 9947 parashikon të drejtat ekskluzive që rrjedhin nga regjistrimi i një marke tregtare pranë DPPI-së. Në situatën faktike dhe ligjore aktuale, i padituri gëzon të gjithë të drejtat legjitime dhe ekskluzive që rrjedhin nga regjistrimi i markës së tij “**** ****” me numër regjistrimi ***.

Si rrjedhojë, kjo dispozitë ligjore nuk mund të shërbejë si baza ligjore kryesore ku mund të mbështetet kërkesë-padia e shoqërisë “****”. Në këtë kuptim, baza ligjore e kërkesë-padisë duhet të mbështetet fillimisht mbi nenet përkatëse të Ligjit 9947 që lidhen me shfuqizimin e markës së palës së paditur, dhe jo mbi të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i një marke. Të drejta të tilla i gëzon njëkohësisht edhe i padituri në sajë të regjistrimit të markës së tij “**** ****”.

Neni 156 i Ligjit 9947 shërben për të rregulluar pasojat eventuale që do të sillte shfuqizimi i markës tregtare të të paditurit dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për të kërkuar shfuqizimin e një marke tregtare. Në rradhë të parë, objekti i padisë dhe kundërpadisë është respektivisht shfuqizimi i markës tregtare “**** ****” (***) dhe markave tregtare “****, ****” (***, **** dhe ***). Në kuptim të ligjit 9947, çdo markë e regjistruar që shfuqizohet për arsye se është aplikuar në keqbesim, konsiderohet si e paqenë duke filluar nga data e depozitimit të markës. Për këtë arsye, pas shqyrtimit të padisë dhe kundërpadisë, gjykata ka detyrimin të vendosë mbi kërkesat e palëve duke rregulluar edhe pasojat e vendimit të saj në lidhje me mosshkeljen e të drejtave të pronësisë industriale në përputhje me nenin 156 të ligjit 9947.

Në këtë kuadër, paditësi nuk mund të pretendojë shkelje të të drejtave të tij të pronësisë industriale. Për më tepër, persa koeh që vërtetohet se aplikimet e markave “****, ****” janë bërë në keqbesim nga paditësi, ai nuk do të gëzojë më asnjë të drejtë të pronësisë industriale dhe nuk do të mund të përdorë këtë markë apo çdo markë tjetër të ngjashme gjatë veprimtarisë së tij tregtare.

I pathemelte është pretendimi i paditësit se shoqëria “****” ka shkelur dispozitat ligjore të Kodit Civil në lidhje me konkurrencën e pandershme, pasi paditësi nuk argumenton konkretisht se cilat nga pikat e nenit 638 të Kodit Civil është shkelur nga i padituri.

Në lidhje me këtë pretendim të paditësit, u provua në gjykim se i padituri nuk ka kërkuar të regjistrojë produktin e paditësit, por ai ka aplikuar për të regjistruar shenjën dhe emrin e tij dallues si markë tregtare. Në këtë kontekst, i padituri thjesht përdor në mënyrë të ligjshme një shenjë/emër dallues që i përket ekskluzivisht vetëm atij. Përkundrazi, veprimet e kryera nga ana e paditësit duke aplikuar për të regjistruar shenjën dalluese “****” të shoqërisë “****” (shoqëria prodhuese e produkteve të miellit nën markën “****” dhe njëkohësisht furnizuesi i palës paditëse me këto produkte), përbëjnë veprime të konkurrencës së pandershme dhe bien haptazi në kundërshtim me nenin 638 (1) të Kodit Civil.

Së fundmi, paditësi pretendon se pala e paditur ka shkelur të drejtat e saj të pronësisë industriale duke eksportuar mallin miell gruri nën markën e saj dhe duke e tregtuar atë në tregun shqiptar.

Një pretendim i tillë është terësisht i gabuar dhe i pambështetur në ligj. I padituri nuk ka kryer asnjë shkelje të ligjit 9947 dhe të drejtave të pronësisë industriale të paditësit për aq kohë sa ai ka prodhuar, tregtuar dhe eksportuar mallin miell gruri “****” nën markën e tij të regjistruar “**** ****”. Në këto kushte, paditësi apo çdo subjekt tjetër, nuk mund të pretendojë shkeljen e të drejtave të pronësisë industriale me argumentin që një person tjetër përdor një markë të ngjashme me markën e tij për aq kohë sa kjo markë figuron rregullisht e regjistruar në regjistrin e markave të DPPI-së. Përkundrazi, është paditësi ai që kryer veprime të konkurrencës së pandershme dhe ka shkelur të drejtat e pronësisë industriale të të paditurit. Në çdo rast, një pretendim i tillë është edhe më i pabazuar po t’i referohemi faktit se vetë paditësi pranon disa herë dhe në mënyrë të përsëritur faktin se eksportuesi i mallrave origjinale të miellit është shoqëria “****”.

Sa me sipër u arsyetua kerkese-padia duhet të rrezohet si e tillë pasi është e pa bazuar në igj dhe në prova.

Në lidhje me kunder-padine, gjykata çmon se ajo duhet të pranohet si e tillë pasi është e

bazuar ne ligj dhe ne prova sa me poshte arsyetohet.

Ne lidhje me piken e pare te saj, siç u përmend edhe më sipër, kërkesat për shfuqizimin e markave tregtare “***, ****” me numër regjistrimi *** , *** dhe *** bazohen në nenin 173(1)(b) të Ligjit 9947, i cili përcakton shprehimisht se: Një markë e regjistruar mund të shfuqizohet kur: (b) aplikimi për regjistrimin e markës është bërë në keqbesim

Në të njëjtën kohë, paditësi/i kundërpaditur ka shkelur në mënyrë të hapur edhe nenin 638(1) të Kodit Civil që parashikon veprimet e konkurrencës së pandershme. Shoqëria “****” ishte në dijeni të plotë dhe ka pranuar se pronari dhe prodhuesi i produkteve të miellit me shenjë “****” ishte dhe mbetet shoqëria ***. Në këto rrethana, paditësi/i kundërpaditur ka nënshkruar marrëveshje dhe kontrata me shoqërinë *** vetëm në lidhje me blerjen dhe furnizimin e produkteve të miellit “****”.

Shenja dhe emri “****” është shenja dhe emri dallues që përdoret ligjërisht nga shoqëria *** , fakt të cilin e pranon dhe vetë paditësi/i kundërpaditur-shoqëria ***. Në këto kushte, shoqëria *** ka përdorur në mënyrë të paautorizuar shenjën/emrin dallues “****” të shoqërisë *** , duke aplikuar pranë DPPI-së për regjistrimin e markave “****” në keqbesim. Një veprimtari e tillë përbën një nga veprimet e konkurrencës së pandershme të kryer nga shoqëria *** që vërteton plotësisht ekzistencën e keqbesimit.

Shoqëria *** ka aplikuar në mënyrë të paautorizuar për regjistrimin e markave “****” në emër të saj dhe në kundërshtim me parimin e përgjithshëm të besimit që karakterizon marrëveshjet e bashkëpunimit tregtar. Përvetësimi i këtyre markave nga shoqëria *** është veçanërisht i dëmshëm për interesat tregtare të pronarit real dhe të vërtetë të markë, shoqërisë “****”. *** , duke shfrytëzuar njohuritë dhe eksperiencën e fituar gjatë marrëdhënies së biznesit me *** dhe në kundërshtim me marrëdhëniet e drejta tregtare, ka aplikuar në keqbesim për regjistrimin e markave “****”, duke përfituar në mënyrë të padrejtë nga përpjekjet dhe investimet e konsiderueshme që *** ka realizuar për këtë markë.

Një qëndrim i tillë është mbajtur në disa raste edhe nga Gjykata Europiane e Drejtësisë (Vendimi i datës 06/09/2006, T-6/05, First Defense Aerosol Pepper Projector; vendimi i datës 19/05/2011, R85/2010-4, LINGHAMS’S (fig.) vs. LINGHAMS’S; vendimi i datës 03/08/2010, R 1231/2009-2, BERIK (fig) vs. BERIK at al.; vendimi i datës 1547/2006-4, Poëerball vs Poëerball, etj.), ku është njohur e drejta legjitime e pronarit të vërtetë e real të markës për të kërkuar shfuqizimin e një marke të regjistruar në keqbesim dhe në kundërshtim me parimin e besimit që duhet të karakterizojë marrëdhëniet e bashkëpunimit tregtar.

Për më tepër, një e drejtë e tillë i është njohur pronarit legjitim të markës, pavarësisht territorit në të cilin është regjistruar marka e tij e mëparshme, në mënyrë që t’i japë mundësi mbajtësit të të drejtës që të mbrohet kundrejt këtyre aplikimeve mashtruese të bëra në keqbesim. Për shembull, Gjykata Europiane e Drejtësisë, në vendimin e saj të datës 19/05/2011, R85/2010-4, LINGHAMS’S (fig.) vs. LINGHAMS’S, njohu të drejtën e pronarit të vërtetë të markës për të kundërshtuar një aplikim të bërë në keqbesim nga agjenti/bashkëpunëtori i tij në territorin e Bashkimit Europian, bazuar në certifikatën e regjistrimit fillestar të markës në Zyrën e Pronësisë Industriale të Malaizisë. Gjithashtu, ekzistenca e një kontrate apo marrëveshjeje formale midis palëve përbën një provë evidente që përcakton përfundimisht pranimin e keqbesimit në aplikimin për regjistrim të markës.

Në kuptim të ligjit dhe bazuar në përkufizimin që doktrina juridike kombëtare e ndërkombëtare ka dhënë për nocionin e keqbesimit, aplikimet për regjistrimin e markave

“****” (numër regjistrimi ***, *** dhe ***) nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. përmbushin të gjithë kushtet e nevojshme për t’u konsideruar si të bëra në keqbesim, Kështu:

Keqbesimi duhet të ekzistojë në momentin e aplikimit për regjistrim të markës

Faktet dhe provat që paraqiten në gjykatë për të analizuar keqbesimin në aplikimin e markave, duhet të vertetojnë ekzistencën e keqbesimit në momentin e aplikimit për regjistrim të markës. Në veçanti, këto fakte duhet të përfshijnë rrethanat në të cilën është krijuar marka tregtare dhe mënyrën e përdorimit të saj që prej krijimit.

Në interpretim të kësaj në lidhje me rastin konkret, nga provat e paraqitura në këtë proces gjyqësor, marka “****” është krijuar shumë vite më parë nga shoqëria ***. Gjithashtu, *** ka regjistruar më përpara në kohë (viti 2012) një numër të madh markash tregtare nën emrin “****” në Agjencinë e Pronësisë Industriale të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, *** ka vazhduar marrëdhëniet e saj të bashkëpunimit tregtar me shoqërinë ***, marrëdhënie të cilat kanë nisur që nga viti 19909.

Marrëdhëniet e bashkëpunimit tregtar ndërmjet këtyre shoqërive janë materializuar në kontrata të vazhdueshme furnizimi dhe shit-blerjeje të produkteve të miellit (shih provat bashkëlidhur). Pra, pronari i markave të regjistruara në keqbesim, ka qenë në dijeni të plotë rreth të drejtave të shoqërisë *** mbi markën “****” në momentin që ka depozituar aplikimin për regjistrim.

Ekzistenca e keqbesimit

Siç u sqarua edhe më sipër, keqbesimi mund të përshkruhet si një sjellje që devijon nga parimet e njohura dhe të pranuara të sjelljes etike apo praktikave të ndershme të biznesit dhe tregtisë. Për të përcaktuar nëse aplikimi për regjistrim i markës është bërë në keqbesim, vlerësohen faktorët e mëposhtëm, si:

Ngjashmëria identike/konfuzuese e shenjave

Marka e regjistruar në keqbesim duhet të jetë identike ose tejet e ngjashme me shenjën të cilës i referohet personi që kërkon shfuqizimin e markës.

Në rastin konkret, markat “****” të regjistruara nga shoqëria *** janë terësisht identike me shenjën dhe markat e regjistruara më parë në Kosovë nga shoqëria ***. Ngjashmëria identike dhe imitimi në keqbesim i shenjës së *** është kaq evident, sa pronari i markave të regjistruara në keqbesim, thjesht ka zëvendësuar emrin e prodhuesit të pronarit real të markës - “****” me emrin e tij - “****”. Në kushtet e një keqbesimi të tillë flagrant, shoqëria *** ka aplikuar për regjistrimin e markave “****” për mallrat e klasës 30 të Klasifikimit të Nicës, mallra që përkojnë plotësisht me llojin dhe natyrën e produkteve të prodhuara nga shoqëria ***.

“****” - Disa nga shenjat dhe markat e regjistruara më parë në Kosovë

“****” - Marka e regjistruar në keqbesim

“****” - Disa nga shenjat dhe markat e regjistruara më parë në Kosovë

“****” - Marka e regjistruar në keqbesim

“****” - Disa nga shenjat dhe markat e regjistruara më parë në Kosovë

“****” - Marka e regjistruar në keqbesim

Njohuria/pasja dijani për përdorimin e mëparshëm të një shenje identike ose tejet të ngjashme nga një person tjetër

Pronari i markës së regjistruar në keqbesim është në dijani dhe nuk ka se si mos të jetë në dijani për përdorimin e mëparshëm të një shenje identike ose shumë të ngjashme nga një person tjetër për produkte/mallra ose shërbime identike apo të ngjashme

Në rast se palët kanë qenë të përfshira në një lidhje apo marrëveshje biznesi, siç është edhe lidhja apo marrëveshja ndërmjet palëve në rastin konkret, dijenia e pronarit të markës së regjistruar në keqbesim është mëse evidente dhe prezumohet vetvetiu

Ky qëndrim është mbajtur dhe konfirmuar edhe nga Gjykata Europiane e Drejtësisë në një seri rastesh (shih vendimin e datës 11/06/2009, C-529/07, Lindt Goldhase; vendimin e datës 11/07/2013, T-321/10, Gruppo Salini). Për më tepër, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, një prezumim i tillë vlen edhe në rast se shenja është regjistruar më parë në një territor/shtet tjetër të ndryshëm nga ai në të cilin është bërë aplikimi në keqbesim (shih vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë të datës 28/01/2016, T-335/14, Doggis).

Pronari i markave të regjistruara në keqbesim – shoqëria ***, jo vetëm që ka pasur njohuri të plotë për pronësinë e vertetë dhe reale mbi shenjën/markën “****”, por ai ka qenë i informuar në mënyrë të hollësishme mbi çdo detaj dhe çështje që lidhet me produktet e miellit “****” të shoqërisë ***, duke përfshirë këtu natyrisht edhe emrin e brand-it/markës tregtare. Një fakt i tillë është i kuptueshëm, pasi shoqëria *** ka qenë në marrëdhënie kontraktuale të gjata e të vazhdueshme me shoqërinë *** në lidhje me tregtimin, furnizimin dhe shit-blerjen e miellit “****”.

Ky fakt provohet qartësisht nga kontratat e bashkëpunimit tregtar të lidhur midis dy shoqërive si ato të furnizimit dhe ato të shitblerjeve që nga viti 2009 e në vijim

Keqbesimi i pronarit të markës së regjistruar

Keqbesimi i pronarit të markës së regjistruar ekziston në të gjithë ato raste kur mund të konkludohet se qëllimi i aplikimit të tij konsiston në përfitimin dhe marrjen e avantazheve të padrejta nga reputacioni i shenjës/markave të personit që kërkon shfuqizimin e markës, siç është në rastin konkret shoqëria “****” (shih vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë të datës 08/05/2014, T-327/12, Simca).

Pra, jemi në kushtet e keqbesimit në të gjithë ato raste kur aplikimi për regjistrim marke devijon nga qëllimi fillestar dhe depozitohet në mënyrë spekulative ose vetëm për të përfituar financiarisht (shih vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë të datës 07/07/2016, T-82/14, Luceo).

Në këtë drejtim dhe si kundërpërgjigje, shoqëria *** ka regjistruar markën “****” me numër regjistrimi *** në DPPI si një mjet mbrojtës ndaj veprimeve të konkurrencës së pandershme të shoqërisë *** dhe markave “****, ****” të aplikuara në keqbesim nga ky i fundit.

Lidhur me sa më sipër, praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të Drejtësisë dhe doktrina juridike kanë përcaktuar se ekzistenca e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ose indirekte

midis palëve përpara datës së depozitimit të aplikimit për regjistrim marke (p.sh. një para-kontratë, një lidhje kontraktuale ose post-kontraktuale) shërben si një tregues i qartë i keqbesimit të pronarit të markës së regjistruar (shih vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë të datës 01/02/2012, T-291/09, Pollo Tropical chicken on the grill; shih vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë të datës 11/07/2013, T-321/10, Grupo Sallin).

Në këtë mënyrë, sa edhe më sipër u arsyetua, midis shoqërisë-prodhuese të mallrave të miellit “****”, si pronari legjitim i kësaj marke, dhe shoqërisë ***, si aplikues në keqbesim i markave, ka ekzistuar një marrëdhënie kontraktuale biznesi në fushën e tregimit, furnizimit dhe shit-blerjes së miellit nën emrin/markën “****”. Kështu, në kontratat mbi shit-blerjen e mallrave miell dhe hime që janë lidhur në vazhdimësi dhe me pëlqimin e lirë e të plotë të palëve, është përcaktuar shprehimisht si më poshtë:

“Shitësi është pronar i produkteve dhe brendeve “****” dhe “****”, si produkte primare, si dhe posedon sasi të konsiderueshme të Himeve si produkte sekondare; Ndërsa Bleresi është klient i rregullt i shitësit dhe i cili distribuon produktet e shitësit për tregun e Republikës së Shqipërisë.”

Gjithashtu, vetë shoqëria “****” sh.p.k., në një letër drejtuar Ministrit të Buqësisë të Republikës së Shqipërisë mbi çështjen e importit të miellit nga Kosova, pohon si më poshtë: “Ne si kompani, *** shpk, jemi distributorë ekskluzivë për Shqipëri të produkteve të fabrikës së përpunimit të grurit, respektivisht fabrika për prodhimin e miellit *** nga Kosova me brende “****” dhe ***, që nga viti 2008.”

Si përfundim dhe bazuar në provat e sipërpërmendura, rezulton se aplikimet për regjistrimin e markave “****” nga ana e shoqërisë *** janë bërë në keqbesim të pastër. Kjo provohet shumë qartë edhe nga fakti se vetë “****” njej dhe pranon faktin që pronari legjitim dhe i vërtetë i markës “****” është shoqëria kosovare ***.

Si rrjedhojë, *** duke qenë në një marrëdhënie bashkëpunimi tregtar me ***, në cilësinë e distributorit të produkteve të miellit “****”, ka shkelur të gjithë parimet dhe praktikatat e ndershme të biznesit/tregtisë duke aplikuar për regjistrimin e kësaj marke në DPPI-së në kushtet e keqbesimit të pastër.

Në këto rrethana, duke qenë se markat tregtare “****, ****” me numër regjistrimi 15370, 15371 dhe 15372, janë aplikuar në keqbesim, ato duhet të shfuqizohen. Si pasojë, marka “****, ****” me numër regjistrimi ***, në pronësi të shoqërisë ***, do të mbetet e vetmja markë “****” e regjistruar në regjistrin e markave tregtare të DPPI-së.

Nisur nga ky fakt, shoqëria *** në cilësinë e pronarit të markës “****, ****” me numër regjistrimi ***, do të gëzojë rrjedhimisht të gjithë të drejtat ekskluzive që rrjedhin nga regjistrimi i markës në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” (i ndryshuar).

Në bazë të nenit 156 (1) të Ligjit 9947 pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të saj. Më tej, në pikën 2 të këtij neni parashikohet shprehimisht se: Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka; b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja,

me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare; c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës

Në mbështetje të këtij neni, i padituri/kundërpaditës - shoqëria *** - ka të drejtën absolute të ndalojë çdo person që përdor në aktivitetin e tij tregtar një shenjë të njëjtë ose të ngjashme me markën ***, pa autorizimin e tij.

Gjithashtu, sipas pikës 3 të nenit 156, ndalohet edhe: a) vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre; b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime; c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë; ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë; d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete

Në këto rrethana, duke qenë se veprimtaria tregtare e paditësit/të kundërpaditur, shoqërisë ***, konsiston në prodhimin, tregtimin, shpërndarjen dhe ofrimin për shitje të mallrave/produkteve mielli që mbajnë shenjën “****”, atehere çmohet se veprimtaria e tij shkel të drejtat e pronësisë industriale të shoqërisë ***, duke shkaktuar një konfuzion të lartë në rradhët e konsumatorëve/publikut përkatës. Në të njëjtën kohë, si pasojë e veprimeve të ndërmarra nga shoqëria ***, shoqëria *** pëson një dëm ekonomik dhe moral të jashtëzakonshëm.

Sigurisht, shoqëria ***, në shkelje të të drejtave të pronësisë industriale të ***, dëshiron të përfitojë nga emri dhe reputacioni tejet i mirë i ***, prandaj hedh në treg mallra të njëjtë që mbartin etiketa të njëjta me mallrat dhe markat e shoqërisë prodhuese të miellit ***. Në rast të kundërt, shoqëria *** mund të hidhte në treg produktet e miellit nën emrin “****” pa përdorur etiketën dhe markat “****” që mbajnë produktet e shoqërisë prodhuese të miellit ***: shoqëria ***.

Paditësi-i/kundërpaditur, nëpërmjet përdorimit të shenjave dalluese ***, sjell një ngatërresë e konfuzion në një shkallë jashtëzakonisht të lartë në radhët e konsumatorëve, të cilët kur blejnë produktet e tij, mendojnë dhe besojnë se në fakt po blejnë produktet e miellit “****” të shoqërisë “****”, të cilat për shkak të kohës shumë të gjatë në treg, emrit të mirë dhe reputacionit, si dhe të cilësisë së lartë, janë tashmë mjaft të njohura në radhët e konsumatorëve dhe publikut në tërësi.

Bazuar në arsyet ligjore e sipërpërmendura, gjykata rregullon edhe pasojat juridike që sjell vendimi për shfuqizimin e markave tregtare “****, ****” me numër regjistrimi ***,** dhe *** duke pasur parasysh dëmin ekonomik të lartë të pësuar nga i padituri/kundërpaditës. Si rrjedhojë e shfuqizimit të markave të tij, paditësi/i kundërpaditur duhet të ndalojë përdorimin e markës ***/*** dhe çdo shenje tjetër të ngjashme me të gjatë ushtrimin të veprimtarisë tregtare, ashtu si edhe mospërsëritjen e veprimeve të tilla në të ardhmen.

Një përdorim i tillë i paligjshëm i kësaj shenje nga paditësi-i/kundërpaditur shkakton njëherazi edhe një konkurrencë të pandershme të një niveli të lartë, në bazë të nenit 638 të Kodit Civil, duke i shkaktuar një dëm të konsiderueshëm shoqërisë ***.

(fig.) vs. LINGHAMS'S; vendimi i datës 03/08/2010, R 1231/2009-2, BERIK (fig) vs. BERIK at al.; vendimi i datës 1547/2006-4, Powerball vs Powerball.

Gjykata Europiane e Drejtësisë ka gjykuar një seri rastesh të ngjashme, ku agjenti ose distributori i prodhuesit të mallrave/pronarit të markës ka aplikuar në mënyrë të paautorizuar dhe në keqbesim për regjistrimin e markës nën emrin e tij. Në të gjithë këto raste, qëndrimi dhe vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë ka qenë i prerë: Marka e regjistruar në mënyrë të paautorizuar nga agjenti, bashkëpunëtori apo distributori i prodhuesit të mallrave/pronarit të markës duhet të shfuqizohet, pasi pronësia mbi këtë markë i takon vetëm pronarit real të saj që ka krijuar dhe përdorur ligjërisht shenjën në fjalë.

Si përfundim, në rast se paditësi/i kundërpaditur do të kishte qenë në kushtet e mirëbesimit gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit tregtar, ai mund të kishte aplikuar fare mirë për regjistrimin e një marke nën emrin "****" pa përfshirë në të shenjën "****", shenjë që përdoret dhe i përket ligjërisht shoqërisë "****". Gjithashtu, i padituri/kundërpaditës ka prodhuar dhe vazhdon ende të prodhojë mallrat e llojit miell gruri nën markën e tij të regjistruar "**** ****". Pavarësisht këtij fakti, i padituri/kundërpaditës nuk ka asnjë detyrim për të njoftuar shoqërinë "****", distributorët e tij aktualë apo çdo person tjetër në lidhje me aplikimet dhe regjistrimet e markave tregtare që ai ka kryer apo do të kryejë në të ardhmen.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin dhe provën e paraqitur nga paditësi/i kundërpaditur mbi ekzistencën e produkteve të miellit "****" me shënimin vijues në ambalazh: Distributor për Shqipërinë: "****" shpk, provohet se i padituri/kundërpaditës nuk ka futur në tregun shqiptar asnjë produkt të miellit nën markën e tij të regjistruar "****" duke shënuar emrin e shoqërisë "****" si distributor të saj. Për këtë arsye, nuk ekziston asnjë faturë apo deklaratë doganore që të vërtetojë futjen në territorin e Republikës së Shqipërisë së produkteve të miellit "****", ku të jetë shënuar emri i shoqërisë "****" në cilësinë e distributorit.

Pavarësisht faktit se ky pretendim i paditësit/të kundërpaditur është jashtë objektit të gjykimit, provohet se produktet e miellit nën markën dhe ambalazhin e ri "****" janë prodhuar nga shoqëria "****" për të furnizuar shoqërinë "****" në kuadër të marrëdhënieve të tyre të bashkëpunimit tregtar. Politikat e marketingut dhe mënyra e ambalazhimit të produkteve janë kompetencë dhe e drejtë ekskluzive e fabrikës së prodhimit të mallrave: "****". Për këtë arsye, sipas pohimit të pales se paditur/kunderpaditese në janar të vitit 2018, shoqëria "****" në cilësinë e prodhuesit të mallrave origjinale të miellit "****" dhe "****", ka vendosur të ndryshojë ambalazhin dhe logon e produkteve të saj duke vendosur të përdorë markën e saj të re "****".

Pikërisht, në këtë moment, shoqëria "****", në cilësinë e distributorit të mallrave të miellit të prodhuara nga "****", ka vendosur që të mos pranojë ambalazhin dhe logon e re "****" dhe refuzoi të marrë në ngarkim mallrat në fjalë. Ashtu si edhe në çdo rast tjetër, ambalazhi i ri i mallrave të miellit ishte porositur nga shoqëria prodhuese "****" paraprakisht në përputhje me politikat e saj tregtare.

Në këto mënyra në momentin e refuzimit të ngarkimit të këtyre mallrave nga "****", shoqëria "****" ka vendosur që t'i kthejë mjetet monetare të parapaguara shoqërisë "****" dhe të mos lejojë hyrjen e asnjë malli të tillë (d.m.th. mallrat e miellit me ambalazhin dhe logon e re "****", ku shënohej se distributor për Shqipërinë ishte "****") në territorin e

Republikës së Shqipërisë. Natyrisht, asnjë subjekt tregtar nuk do të kishte interes dhe nuk do të pranonte të importonte mallrat e shoqërisë “****” me shënimin “Distributor për Shqipërinë: ****”.

Për sa i përket kërkesave të të paditurit/kundërpaditës lidhur me pushimin e cënimit të të drejtave të tij të pronësisë industriale dhe marrjen e masave përkatëse të parashikuara nga ligji 9947 në këtë drejtim, për gjykatën këto kërkesa lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me pasojat që duhet të rregullohen nga gjykata në rast të shfuqizimit të markave “****, ****”. Në këtë kontekst, ligji 9947 përcakton shprehimisht të drejtën e pronarit të një marke tregtare që të ndalojë përdorimin e një shenje identike ose të ngjashme për të njëjtën kategori apo lloj mallrash/shërbimesh. Pra, masat ligjore të parashikuara shprehimisht nga ligji specifik 9947 nuk synojnë ndalimin e përdorimit të markës *** (në asnjë rast nuk pretendojmë se paditësi/i kundërpaditur tregton mallra nën emrin ***), por ato kanë për qëllim të ndalojnë rreptësisht përdorimin e shenjës *** (shenje identike ose shumë e ngjashme me markën e regjistruar ***) nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. në rast se markat “****, ****” do të shfuqizohen për shkak të aplikimit të tyre në keqbesim.

Të gjithë kërkesat e përcaktuara në objektin e kundër-padisë lidhen me pretendimet e shoqërisë “****” mbi ndalimin e përdorimit në mënyrë të paautorizuar të markës së saj *** apo çdo shenje tjetër të ngjashme me të, duke përfshirë këtu sigurisht edhe shenjën ***. Pretendime të tilla janë terësisht të mbështetura dhe të bazuara në ligjin 9947: nenet 156 dhe 184/b të ligjit.

Për më tepër, një pretendim i tillë i paditësit është edhe më i pakuptimtë po të konsiderojmë faktin se vetë paditësi/i kundërpaditur ka përcaktuar në objektin e kërkesë-padisë së tij një kërkim që është ekzaktësisht i njëjtë me atë që ai kundërshton në lidhje me kundër-padinë: Detyrimi i palës së paditur shoqërisë “****” shpk, të ndalojë përdorimin e markës tregtare “**** ****” (fjalë dhe figurë), nga të gjitha produktet ushqimore të përfshira në klasën 30 të Klasifikimit të Nices, duke përfshirë ndalimin e importit në territorin shqiptar, tregtimit, fushave publicitare në mediat kombëtare, rrjetet sociale dhe materialeve të tjera promovuese si dhe reklamimin e produkteve ushqimore (miell gruri) nën markën “ **** ****” me numër *** e ***, me datë regjistrimi 06.09.2016, që në figurë përmban fjalën ***, dhe mospërsëritjen e këtyre veprimeve në të ardhmen.

Së fundmi, krahas faktit që paditësi/i kundërpaditur nuk i bazon pretendimet e tij në dispozitat ligjore e ndryshuara të ligjit 9947, ai pretendon në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin 9947 se kërkesa për shfuqizimin e markave “****, ****” është parashkruar. Kërkesa për shfuqizimin e një marke tregtare sipas nenit 173 të ligjit 9947 nuk parashkruhet dhe mund të depozitohet në çdo kohë nga çdo person i interesuar. Për më tepër, kërkesa për shfuqizimin e një marke tregtare të aplikuar në keqbesim nuk parashkruhet edhe në rast se kjo markë tregtare mund të jetë regjistruar dhe përdorur prej çfardollosjesh periodike kohore.

Në këto konkluzione të saj lidhur me kërkesë-padine dhe kundër-padine, gjykata mban parasysh edhe vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Nr. 101 datë 21. 06. 2000 dhe Nr. 4 datë 01. 02. 2006, sipas të cilave, në çështjet ku gjykohet bashkërisht padia e paditësit dhe kundërpadia e të paditurit, gjykata mund të vendosë, sipas

rastit:

- a) Pranimin e padisë dhe të kundërpadisë, duke vendosur kur është rasti, edhe ndër shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella;
- b) Pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë;
- c) Rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë dhe
- ç) Rrëzimin si të padisë, ashtu edhe të kundërpadisë.

Se fundmi lidhur me pagimin e shpenzimeve gjyqesore referuar Nenit 106 e vijues te K. Pr. Civile nga pala e paditur kunderpaditese u paraqiten bashke me konkluzionet perfundimtare dhe faturat tatimore te shpenzimeve gjyqesore Nr. s'ka dt. *** ne shumen *** Euro dhe Nr. *** dt*** ne shumen *** Euro. Gjykata nga ana e saj çmoi te mos i pranoje keto vlere te plote te shpenzimeve gjyqesore per perfaqesimin ne gjykate, pasi i gjen ate jo reale lidhur me natyren e konfliktit gjyqesor, kohezgjatjen e tij dhe ne shperpjestim me interesat pasurore te paleve ndergjyqese lidhur me te drejtat dhe detyrimet reciproke. Ne kete menyre gjykata njeh si shpenzime perfaqesimi per palen paditese, vetem vleren ne masen *** leke, shpenzim ky qe duhet te paguar i plote vetem ne kete mase ***, krahas shpenzimeve te tjera qe lidhen me taksen gjyqesore, qe duhet te paguhen nga pala paditese e kunderpaditur.

Për sa më sipër u analizua gjykata çmon se kërkesë-padia është e pa bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet rrezuar, ndersa kunder-padia duhet pranuar si e tille teresisht.

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar ne Nenet 126, 306-308 e vijues te K. Pr. Civile,

VENDOSI :

Rrëzimin e kërkesë-padisë si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova.

Pranimin e kunder-padise.

Shfuqizimi i markave tregtare “***, ***” (fjale dhe figure) me numra regjistrimi ***,*** dhe *** pasi aplikimi per regjistrimin e markave eshte bere ne keqbesim nga shoqeria *** sh.p.k.

Regjistrimi i vendimit te shfuqizimit te markave “***, ***” (fjale dhe figure) me numra regjistrimi ***, *** dhe *** ne regjistrin e markave tregtare te Drejtorise se Pergjithshme te Prones Industriale.

Pushimi i cenimit te te drejtave te pronesise industriale te shoqerise “****” sh.p.k nepermjet ndalimit te Paditesit te Kunderpaditur-shoqerise “****” sh.p.k, qe te perdore marken tregtare *** dhe çdo shenje tjeter te ngjashme me te, gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare, pa autorizim te shoqerise “****” sh.p.k, duke perfshire edhe perdorimin e tyre per qellime marketing, reklamimi ose publiciteti.

Ndalimi i Paditesit te Kunderpaditur-shoqeria “****” sh.p.k, qe te perdore dhe te vendose marken tregtare *** dhe çdo shenje tjeter te ngjashme me te, ne mallrat ose amballazhet e tij;

Ndalimi i Paditesit te Kunderpaditur- shoqeria “****” sh.p.k, qe te prodhoje, eksportoje, importoje, shperndaje, hedhe ne treg, ofroje per shitje, magzinoje, reklamoje, dhe/ose te

ambalazhoje produktet e tij me etiketen e markes *** dhe çdo shenje tjeter te ngjashme me te.

Bllokimi dhe shkaterrimi, me shpenzimet e Paditesit te Kunderpaditur- shoqerise “****” sh.p.k, te te gjithë produkteve te miellit “****”, te prodhuara dhe te shperndara ne tregun shqiptar (me shumice ose pakice) nga Paditesit/Te Kunderpaditur, shoqerise “****” sh.p.k, si dhe te gjithë produkteve te tjera qe mund te gjenden tek çdo subjekt tregtar, ne magazine ose ne çdo vend tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Ndalimi i veprimeve te konkurrences se pandershme nga Paditesi/i Kunderpaditur, shoqeria “****” sh.p.k, dhe mosperseritja e veprimeve te tilla ne te ardhmen.

Publikimi i vendimit perfundimtar te gjykates ne median publike me shpenzimet e Paditesit /te Kunderpaditur, shoqerise “****” sh.p.k.

Ky vendim eshte i ekzekutushem nga permbaruesi gjyqesor.

Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditese te kunderpaditese shoqeria « *** » sh.p.k.

Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paleve ndergjyqese.

U shpall sot me date 13. 06. 2018 ne Tirane.

SEKRETARE
GJYQTAR

LUSJANA FEZOLLARI
POLLOZHANI

ERVIN

Shpenzimet gjyqësore

Taksë padie	3 000 lekë	
Takse kudner-padie	3 000 lekë	
Shpenzime av. pales se kunderpaditur	*** lekë	
Shpenzime njoftimi llog gjykates	500 lekë	
Totali		*** lekë